



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”

ofruar nga

Universiteti "Mesdhetar i Shqipërisë"

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

**Prof. Asoc. Dr. Gentiana Kraja
Dr. Erida Elmazi**

Qershor /2025

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”

1	IAL aplikues:	Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare.
3	Emërtimi i programit të studimit:	Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Urdhër Nr. 239, datë 19.07.2021
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Urdhër Nr. 239, datë 19.07.2021
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë i studimit
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	18 PAE / 4 PAK (2023-2024) 16 PAE/ 2 PAK (2022-2023)
18	Numri i studentëve:	105 AP dhe 36 PIQ regjistruar nga 2021 - 2024
19	Komente / të tjera:	-

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” është një program studimi me kohë të plotë, me 180 kredite, që ofrohet në 6 semestra apo 3 vite akademike, në gjuhën shqipe, në përfundim të të cilave merret diploma me profilet përkatëse. Me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 19.02.2009 është bërë licencimi Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Me Urdhërin nr. 124, datë 29.03.2012 MAS është hapur për herë të parë programi i studimit i ciklit të dytë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Shkenca Politike” dhe “Administratë Publike”. Në vitin 2018 programi i studimit i ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Shkenca Politike” dhe “Administratë Publike” ka kaluar akreditimin e parë me Vendim BA nr. 61 datë 28.09.2018. Ky program studimi është riorganizuar dhe i ka ndryshuar emërtimi sipas Urdhrit nr. 239 datë 19.07.2021 aktualisht programi i studimit emërtohet Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”

Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka përcaktuar qartë drejtimit prioritar akademike në dokumentet e veta strategjike dhe synon ndërtimin e të gjitha kurrikulave në përputhje me kërkesat e ‘Kartës së Bolonjës’ dhe përshtatjen e tyre me ndryshimet social-ekonomike dhe zhvillimet e tregut të punës. Realizimi i këtyre prioritetëve synohet nëpërmjet përbushjes së misionit të IAL Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë të përcaktuar në Statutin e tij dhe aktet e tjerë ligjorë dhe strategjik.

Përgjatë procesit të vlerësimit të jashtëm, GVJ konstatoi se ky program studimi është ofruar në përputhje me këto prioritete. Ofrimi i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e tij janë në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të IAL – Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Ky program studimi ofron njohuri teorike dhe aftësi praktike në fushën e Shkencave Politike, Qeverisjes, Integrimit dhe Administrimit Publik etj. Studenti, i cili zotëron një diplomë të tillë mund të punësohet si specialist në organizatat e sektorit publik, si dhe në kompanitë private në fushat e lartpërmendura.

Ky raport u përgatit nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm dhe ka për qëllim vlerësimin në kuadër të akreditimit për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Vlerësimi i jashtëm i këtij programi studimi është përgatitur nga një grup ekspertësh të kontratuar nga ASCAL. Grupi i vlerësimit të jashtëm është i përbërë nga: Prof.Asoc.Dr. Gentiana Kraja dhe Dr. Erida Elmazi. Gjatë gjithë këtij procesi GVJ është asistuar nga Msc. Rajna Lila, përfaqësuese e ASCAL.

Për hartimin e raportit, veç raportit të vlerësimit të brendshëm, dokumenteve mbështetës të sjella nga IAL në Dosjen e Vetëvlerësimit, grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) u bazua edhe në vizitën dy ditore që grupi kreu në institucion, si dhe mori në shqyrtim edhe dokumente të tjera dhe informacion të nxjerrë nga takimet dhe intervistat që u kryen gjatë vizitës në institucion, si për shembull me drejtues të departamentit, personelin akademik dhe studentët, përfaqësues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm dhe Cilësisë, GVB, sekretarinë, zyrën e karrierës, punonjësen e bibliotekës, etj.

Në bazë të vlerësimit kanë qenë kriteret e vendosura në Ligjin nr.80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Standardet e Cilësisë të aprovuara në Kodin e Cilësisë, si dhe aktet ligjore e nënligjore përkatëse.

Metodologjia e ndjekur për shkrimin e këtij raporti është analizimi i dokumenteve dhe rishikimi i kriterëve e kërkesave ligjore në lidhje me akreditimin e programeve të studimit të nivelit bachelor në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Vizitat në institucion u kryen në datën 4 dhe 5 Nëntor 2024. Vlerësimi i programit u përqendrua në analizën e përmbajtjes së kurrikulës dhe lëndëve, shpërndarjes së krediteve dhe orëve, literaturës që përdoret, përshtatshmërisë së personelit akademik për lëndët që ligjërojnë, sigurimit të cilësisë, etj.

Rekomandimet e lëna nga Bordi i Akreditimit në Vendimin e BA nr. 61 datë 28.09.20218 ishin Institucioni të sigurojë shpërndarjen e peshës së krediteve përgjatë tre viteve akademike në mënyrë të barabartë, përpara fillimit të vitit akademik 2018-2019, është përmbushur plotësisht dhe rekomandimi i dytë Institucioni, të parashikojë ofrimin e lëndëve me zgjedhje në profilin “Administratë publike”, është realizuar shtimi i lëndëve me zgjedhje në vetëm një semestër në secilin profil.

Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” është në proces riakreditimi.

Koordinator teknik i ASCAL gjatë procesit të vlerësimit të jashtëm është Msc. Rajna Lila.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ofron programe studimi që përputhen me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen e vlerave akademike dhe kulturore shqiptare. Nëpërmjet një qasjeje bashkëkohore dhe të integruar, universiteti ndihmon në zhvillimin e arsimit cilësor, promovimin e identitetit kombëtar dhe përgatitjen e profesionistëve të aftë për tregun e punës. Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” është një program studimi i cili ofrohet në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, Strategjinë për Arsimin e Lartë dhe të gjithë bazën ligjore e nënligjore në fuqi. Programet e studimit të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë janë në përputhje me Strategjinë Kombëtare të arsimit të lartë dhe planet strategjike të tij janë në përputhje me vlerat kombëtare. Në këtë kontekst Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” është në përputhje me vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Edhe pse nuk është një program që ka lidhje me fushat, programi i plotëson kriteret e këtij standardi dhe është në mbështetje të zhvillimit dhe mbrojtjes së interesave kombëtare. <i>Evidence 1 Statuti i UMSH</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative” në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me misionin dhe qëllimet e institucionit, duke iu përgjigjur nevojave akademike dhe profesionale në fushën e administratës publike dhe politikave të integrimit. Me profilet “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, programi synon të përgatisë specialistë të aftë për të kuptuar dhe analizuar proceset e qeverisjes, reformat administrative dhe sfidat e integrimit evropian. Ai kontribuon në ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore

	kombëtare, duke përgatitur studentët për të luajtur një rol aktiv në zhvillimin e politikave publike dhe forcimin e institucioneve shqiptare në përputhje me interesat kombëtare dhe standardet ndërkombëtare. <i>Thelbi i programit fokusohet në formimin e të menduarit kritik tek studentët, me aftësinë për të menduar dhe vepruar njëkohësisht si dhe për të gjykuar situata specifike.</i> <i>Evidenca 4 Plani i Zhvillimit Strategjik UMSH</i> <i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike"</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimeve akademike të tij.	Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike" është hartuar dhe iu ofrohet studentëve në përputhje dhe në zbatim të Planit Strategjik të zhvillimit të Institucionit, Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH). Drejtimet strategjike të zhvillimit të UMSH-së shprehen në Statutin e tij dhe në Planin të Zhvillimit Strategjik të Institucionit, 2018-2023. Statuti dhe rregullorja e UMSH si dhe rregullorja e programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike" përcaktojnë drejtimet prioritare akademike të institucionit dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me to. Programi Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike" është hartuar për t'i ofruar studentëve përgatitjen e nevojshme në përputhje të plotë me fushën e studimit. <i>Evidenca 1 Statuti i UMSH</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike"</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) demonstroi një përvojë të konsoliduar, kapacitete të avancuara dhe burime të mjaftueshme në fushën akademike të Shkencave Politike dhe Administrative, duke garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e programit të studimit Bachelor në këtë drejtim. Me profilet "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike", UMSH ofron një kurrikulë të strukturuar, të mbështetur nga një staf akademik i kualifikuar dhe me përvojë

	në fushën e qeverisjes, administratës publike dhe politikave të integritit. <i>Nga konteksti kurrikular gjatë analizimit konkret të programit të studimit vihet re se kurrikula e profilit Administratë Publike duhet të modifikohet në përputhje me kërkesat e profilit.</i> Institucioni siguron infrastrukturë të përshtatshme, qasje në burime akademike bashkëkohore dhe bashkëpunime me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare, duke u ofruar studentëve një arsim cilësor dhe të përputhshëm me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimin e politikave publike në Shqipëri. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” bazohet në dokumentet strategjike kombëtare dhe institucionale. Plani strategjik institucional, ashtu siç shprehet është në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendët globale të zhvillimit, pasi reflektohet në planet mësimore, programet e lëndëve. Pra, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit të ciklit të dytë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” përputhet me përcaktimet strategjike në nivel makro dhe mikro. <i>Evidenca 15 Përmbledhëse e tabelave per programin e studimit</i> <i>Evidenca 6 Rregullore e Fakulteti të Drejtësisë dhe Shkencave Humane</i>
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë (UMSH) është konceptuar në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë përgjegjëse për këtë program. Duke ndjekur klasifikimin dhe kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare dhe evropiane, programi fokusohet në fushat e shkencave politike, administratës publike dhe politikave të integritit, duke siguruar një balancë të qëndrueshme mes teorisë dhe praktikës. Ai reflekton në një masë të konsiderueshme prioritetet e zhvillimit të administratës publike shqiptare dhe procesit të integritit evropian, duke iu përgjigjur nevojave të tregut të punës dhe kërkesave akademike bashkëkohore. Përmes një kurrikule të përditësuar dhe një qasjeje të orientuar drejt kërkimit shkencor, programi përgatit profesionistë të aftë për të kontribuar në institucionet publike dhe në sektorin politik në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. <i>Sipas Gvj -ës nga</i>

	<i>pikëpamja kurrikulare profili Administratë Publike duhet të përputhet më korrekt me profilin.</i> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësive kryesore, Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane përgjegjës për këtë program, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. <i>Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë e ofron programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatorë të tij. Programi i studimit duhet rishikuar nga pikëpamja kurrikulare në profilin “Administratë Publike” në mënyrë që të realizohet përputhja e nevojës për dije, kompetenca dhe aftësi të profilit dhe disiplinave përkatëse. Ky kriter përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	


Standardi I.2	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) siguron një organizim të mirë strukturuar dhe një bashkëpunim efektiv midis njësive akademike dhe administrative për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Përmes një ndarjeje të qartë të detyrave dhe përgjegjësiwe mes fakulteteve, departamenteve dhe stafit akademik, institucioni garanton funksionimin e duhur të programit, duke siguruar cilësinë dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij. Procesi i menaxhimit dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	mbikëqyrjes realizohet nëpërmjet analizave të rregullta të ecurisë akademike, vlerësimit të performancës së stafit dhe reagimeve të studentëve. Nëpërmjet këtij mekanizmi bashkëpunues, UMSH garanton një mjedis akademik dinamik dhe të qëndrueshëm, që përmbush standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka krijuar ambientet e nevojshme për zhvillimin profesional dhe bashkëpunimin. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit është e përcaktuar në rregulloret dhe aktet e tjera të brendshme të Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, në zbatim të VKM dhe në Udhëzimin e MAS për organizimin e programeve të studimit. Detyrat dhe përgjegjësitë ndahen midis njësive të ndryshme, pesha kryesore e njësisë bazë që është Departamentit Shkencave politike dhe marrëdhënieve Ndërkombëtare realizimin sasior dhe kontrollin cilësor të zhvillimit të programeve të studimit. <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit</i> <i>Evidenca 8 Rregullore e DSHPMN</i>
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në kuadër të implementimit të objektivave dhe strategjisë për zhvillimin institucional ka bërë përpjekjet e duhura për mundësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional në plan kombëtar dhe ndërkombëtar. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka 40 marrëveshje me Institucionet akademike dhe jo akademike, 32 marrëveshje Erasmus + dhe 58 marrëveshje me Biznese/OJF etj. Marrëveshjet janë realizuar në kuadër të aktualizimit dhe profesionalizimit të studentëve si dhe në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit. <i>Evidenca 9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH</i> <i>Dokumentacioni shtesë i përcjellë përmes shkresës Nr.Prot 1553, datë 7.11.2024.</i>
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në funksion të realizueshmërisë së objektivave të programit të studimit ka mundur marrëveshjeje për të realizuar praktikat profesionale nga studentët. Këto marrëveshje janë realizuar me një sërë institucionesh akademike ose jo, biznese OJF, universitete kombëtare dhe ndërkombëtare etj. UMSH është pjesëtar i EMUNI, institucion i rëndësishëm i arsimit të lartë në rajonin Euro-Mesdhetar. Procedurat e zhvillimit të praktikave profesionale janë të rregulluara nëpërmjet akteve të brendshme, në të cilat janë parashikuar si procedurat që duhet të ndiqen ashtu edhe roli i



	aktorëve dhe njësive të ndryshme të përfshira në këtë proces (Udhëzuesi i praktikave). Raporti i Praktikës nënshkruhet dhe personi përgjegjës në institucion përkatës. <i>Evidenca 9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH</i> <i>Evidenca 44 Udhëzues për praktikant</i>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), përmes njësisë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, kryen analiza periodike mbi efektivitetin e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit. Raportet analitike vlerësojnë ndikimin e këtyre marrëveshjeve në përmirësimin e cilësisë akademike, shkëmbimin e eksperiencave me institucione partnere dhe përfshirjen e studentëve në projekte praktike dhe kërkimore. Këto analiza ndihmojnë në përshtatjen dhe përmirësimin e bashkëpunimeve, duke siguruar që partneritetet e universitetit të kontribuojnë në zhvillimin profesional të studentëve dhe në përshtatjen e programit me nevojat aktuale të tregut dhe sfidat e administratës publike dhe politikave të integrimit. Në këtë kuadër analizohet edhe ecuria e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të programit të studimit. <i>Evidenca 9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH</i>			
Konkluzione	<i>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) ka strukturuar programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është i organizuar në lëndë dhe module, duke siguruar një ndarje të qartë të njohurive bazë, profesionale dhe zgjedhore. Çdo lëndë është e përcaktuar me kredite ECTS, duke mundësuar një ngarkesë akademike të balancuar dhe njohje ndërkombëtare të diplomës. Struktura e programit synon t’u ofrojë studentëve një përvojë të plotë akademike, me mundësi për zhvillim profesional dhe integrim të lehtë në tregun e punës, si dhe në vazhdimin e studimeve të mëtejshme në nivel kombëtar dhe evropian. Kurrikulat dhe plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” janë në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi: VKM nr. 41 datë 24.01.20218, i ndryshuar, Vendimin 879, datë 18.12.2019, Plani mësimor pasqyron disiplinat/lëndët duke pasqyruar sistemin e krediteve ECTS sipas parimit të raportit sasior 1/25 (1 ECTS i përgjigjen 25 orë pune mësimore dhe individuale të studentit), konkretisht profili “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” organizohet me: 1. 34 ECTS në kategorinë A të disiplinave, 2. 96 ECTS në kategorinë B, 3. 22 ECTS në kategorinë C, 4. 20 në kategorinë D 5. 8 në kategorinë E. Profili “Administratë Publike” organizohet me: 1. 34 ECTS në kategorinë A të disiplinave, 2. 97 ECTS në kategorinë B, 3. 21 ECTS në kategorinë C, 4. 20 në kategorinë D dhe 8 n kategorinë E. <i>Ndërkohë që përcaktimi sipas bazës ligjore është 27-36 ECTS në kategorinë A të disiplinave, 90-99 ECTS në kategorinë B, 22-27 ECTS në kategorinë C, 18-27 në kategorinë D dhe 5-9 në kategorinë E.</i> <i>Evidenca 13 Planu mësimor Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), përmes programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, synon të përgatisë profesionistë të aftë për një gamë të gjerë karrierash në sektorin publik dhe atë privat. Programi ofron njohuri të thelluara dhe të përparuara në fushën e administratës publike, politikave të integritit dhe qeverisjes, duke zhvilluar një të kuptuar kritik të teorive dhe parimeve akademike. Ai i pajis studentët me aftësi dhe kompetenca të avancuara, të domosdoshme për të analizuar dhe zgjidhur probleme komplekse dhe sfida të paparashikueshme në mjedise të ndryshme profesionale. Përmes një qasjeje të integruar akademike dhe praktike, programi siguron formimin e specialistëve të aftë për të kontribuar në zhvillimin e administratës publike, hartimin e politikave dhe procesin e integritit evropian. Programi i studimit në formimin e kurrikulave, në shtrimin e objektivave si dhe me strukturën akademike si dhe procedurat ndërmjet të cilave operon, i shërben formimit të studentëve sipas dy profileve të këtij programi Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Kompetencat profesionale dhe akademike janë të mundësuar jo vetën nga përmbajtja e programit të studimit por edhe nga forma dhe metodologjia me të cilën ai ofrohet duke ju referuar organizimit të orës mësimore, detyrave individuale apo në grup, praktikë profesionale, realizueshmërisë së tezës së diplomës etj. Këto element të ofrimit të programit të studimit janë të përcaktuar edhe në rregulloren e programit të studimit. <i>Duke ju referuar përbërjes së kurrikulave sipas disiplinave përkatëse si edhe syllabuseve të lëndëve rekomandohet që të përshtaten më mirë me profilin përkatës si dhe kërkesat formuese të diplomës, në mënyrë të veçantë për sa i përket profilin “Administratë Publike”.</i>
Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet	Programet e studimit janë të organizuara në lëndë dhe module, të vlerësuara me kredite, në përputhje me udhëzimin 31 të MASR, si dhe VKM 41 me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Programi

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	zhvillohet në 3 vite akademike, me mundësi transferimi kreditesh sipas standardeve Europiane. Kreditet e programit të studimit për profilin “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” janë të organizuara si vijon: Kategoria A e organizuar sipas 34 krediteve, kategoria B e organizuar sipas 96 krediteve, kategoria C e organizuar sipas 22 krediteve, kategoria D e organizuar sipas 20 krediteve, kategoria E organizuar sipas 8 krediteve, në total 180 ECTS sipas 3 viteve akademike. Kreditet e programit të studimit për profilin “Administratë Publike” janë të organizuara si vijon: Kategoria A e organizuar sipas 34 krediteve, kategoria B e organizuar sipas 97 krediteve, kategoria C e organizuar sipas 21 krediteve, kategoria D e organizuar sipas 20 krediteve, kategoria E e organizuar sipas 8 krediteve, në total 180 ECTS sipas 3 viteve akademike. <i>Evidenca 13 Plani mësimor i programit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i>
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” si në planin mësimor ashtu edhe në kurrikulat ka të përcaktuar mirë ngarkesat mësimore sipas disiplinave dhe sipas kategorive të lëndëve, sipas viteve akademike dhe sipas semestrave respektiv. Gjithashtu në kurrikulat e programit të studimit përcaktohen kreditet dhe modalitetet përkatëse të praktikës profesionale dhe detyrimeve përmbyllëse. Realizimi i detyrimeve përmbyllëse organizohet sipas një procedure të përcaktuar edhe në rregulloren e programit të studimit. Në këtë program studimi praktikat profesionale organizohen sipas 6 krediteve ECTS dhe diploma në 8 kredite ECTS. <i>Evidenca 13 Plani mësimor i programit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të	Nuk aplikohet në këtë program studimi.



ministrisë përgjegjëse për arsimin.				
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Nuk aplikohen në këtë program studimi.			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” është kodifikuar duke u bazuar tek kërkesat e MAS, ky program merr kodin 0312, ndërkohe do të procedohet më tej me kodifikimin respektiv të lëndëve.			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Nuk aplikohen në këtë program studimi.			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatorë, gjithsesi ka vend për të përmirësuar. Duke ju referuar përbërjes së kurrikulave sipas disiplinave përkatëse si edhe syllabuseve të lëndëve rekomandohet që të përshtaten me profilin përkatës. Ky kriter përmbushet kryesisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), përmes njësisë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, siguron përmbushjen e plotë të detyrimeve ligjore për organizimin dhe funksionimin akademik.

Në përputhje me legjislacionin në fuqi, institucioni respekton standardet për strukturën akademike, përzgjedhjen dhe zhvillimin e stafit akademik, si dhe proceset e vlerësimit dhe akreditimit të programit. Me një kurrikulë të përshtatur sipas kërkesave kombëtare dhe ndërkombëtare, UMSH garanton një mjedis akademik cilësor dhe të qëndrueshëm, duke ofruar një formim të plotë për studentët në fushën e administratës publike dhe politikave të integritit.

Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane realizon kriteret ligjore për administrimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Ky departament/fakultet në zbatim të bazës ligjore ka krijuar instrumentet e duhur akademik të realizojë programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” sipas përcaktimeve përkatëse mbi bazën e të cilave është hapur si program. Personeli akademik në funksion të programit është sipas kërkesave të përcaktuara.

DSHPMN ka në përbërje të tij 10 anëtarë të personelit akademik per vitin akademik 2023-2024 të FDSH, 3 personel Akademik janë nga Kategoria Profesor, 5 janë të kategorisë Doktor dhe 2 nga kategoria Asistent lektor konkretisht 1 Prof. Dr., 2 Prof. Asoc. Dr., 5 Dr., dhe 2 Asistent Lektor.

Njësia bazë, ***Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare*** përgjegjës për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik, sipas viteve akademike që paraqiten si më poshtë [Evidencë 15, Tabela 2]:

Tituj/ grada	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	1	-	1	-
Prof. Asoc.	2	-	2	-	2	-



	Dr./PhD.	5	1	6	4	5	4
	Msc.	2	2	2	1	2	1
	Totali	9	3	11	5	10	5
<i>Evidenca 6 Rregullore e FDSH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e DSHPMN</i> <i>Evidenca 15 Përmbledhëse e tabelave për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike"</i>							
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), përmes njësisë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike", siguron përmbushjen e detyrimeve ligjore për organizimin dhe funksionimin e programit, duke angazhuar personel ndihmës akademik dhe administrativ për mbështetjen e procesit mësimor. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, institucioni garanton një strukturë të mirë organizuar për realizimin e praktikave mësimore, kërkimore dhe laboratorike, duke krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve. Personeli ndihmës kontribuon në mbështetjen teknike dhe administrative, lehtësimin e organizimit të seminareve dhe praktikave profesionale, si dhe në sigurimin e burimeve të nevojshme për një eksperiencë mësimore cilësore dhe të përshtatshme me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. <i>Njësia kryesore ka kapacitete njerëzore të cilat i angazhon në realizimin e proceseve mësimore si dhe disiplinave respektive të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike".</i>						
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinitorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike" në përputhje me rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, DSHPMN ka përcaktuar koordinitorin i cili ushtron funksionin e tij në bashkëpunim me sekretarinë e fakultetit. <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSH</i>						
Konkluzione	<i>Njësia kryesore FDSH dhe njësia bazë përgjegjëse DSHPMN për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe</i>						

	<i>Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), përmes njësisë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, disponon të gjitha informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimeve. Institucioni siguron një dokumentacion të qartë dhe të detajuar, që përfshin planin mësimor, programet e lëndëve, objektivat e formimit akademik dhe profesional, si dhe metodologjinë e mësimdhënies dhe vlerësimit. Ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm për studentët, stafin akademik dhe administrativ, duke garantuar transparencë dhe efektivitet në realizimin e programit në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Dokumentacioni për strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, administrohet nga Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si njësi bazë kërkimore shkencore të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane. Njësia bazë dhe njësia kryesore disponojnë kurrikulat, planet mësimore, rregulloren e programit të studimit dhe rregulloren e njësive ndërmjet të cilave administrohet programi i studimit. <i>Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje”</i> <i>Evidenca 13 Plan mësimor Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje”</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), përmes programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, ka hartuar një plan mësimor të qartë dhe të strukturuar, në përputhje me standardet akademike dhe legjislationin në fuqi. Plani mësimor përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, duke përcaktuar ngarkesën mësimore të secilës lëndë/module, numrin e krediteve ECTS, si dhe orët në auditor dhe jashtë auditorit. Ky organizim synon të balancojë teorinë me praktikën, duke ofruar një qasje efektive për zhvillimin akademik dhe profesional të studentëve në fushën e administratës publike dhe politikave të integrimit. Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” pasqyron informacionin në lidhje me shpërndarjen e lëndëve dhe moduleve në semestra, ngarkesën mësimore në auditor, orët jashtë auditorit/studimit individual të studentit. <i>Plani mësimor i organizuar sipas veprimtarive formuese që karakterizojnë programin e studimit ndahet në leksione 810 orë, seminare 705 orë, praktikë profesionale 120 orë dhe diploma 20 orë, ndërkohe që sipas kërkesës ligjore janë planifikuar orë për studim individual si dhe forma e kontrollit të dijeve kryesisht provime.</i> <i>Evidenca 13 Plani mësimor Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje”</i>
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme në lidhje me kriteret e pranimit, transferimit e ekuivalentimit të studimeve. Kriteret për pranimin e studentëve që ndjek Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë për këtë program studimi janë të pasqyruara në Rregulloren përkatëse të Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe të DSHPMN, po ashtu edhe procesi i ekuivalentimit nga IAL të tjera drejt Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë dhe anasjelltas. <i>Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i> <i>Evidenca 3 Broshura e programeve bachelor</i>
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën,	Programet e lëndëve janë subjekt rishikimi para çdo viti akademik me qëllim përditësimin e tyre. Në program gjendet informacioni në lidhje me objektivat e lëndës, temat e lëndës, format e kontrollit të dijeve dhe mënyra e vlerësimit. Në fillim të çdo viti plotësohet për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe

seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” dosja e cila përmban kurrikulën, planet mësimore, ngarkesën e stafit akademik, syllabuset etj. <i>Rekomandohet që personeli akademik i DSHPMN të familjarizohet me procedurën e administrimit të programeve të lëndëve, gjatë takimit të realizuar rezultoi që personeli akademik nuk e njihnte mirë procedurën.</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) siguron që programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, të jetë në një proces të vazhdueshëm përmirësimi dhe përditësimi, në përputhje me kërkesat akademike dhe zhvillimet e fundit në fushën e studimeve politike dhe administrative. Periodikisht strukturat përgjegjëse vlerësojnë dhe miratojnë ndryshimet eventuale në përmbajtjen e programit, duke siguruar përputhjen e tij me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Pas miratimit, e gjithë dokumentacioni arkivohet në një dosje të plotë, e cila përmban planin mësimor të përditësuar, programet e lëndëve dhe të dhënat përkatëse, duke garantuar transparencë dhe efektivitet në administrimin e programit. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” përditësohet periodikisht në fillim të çdo viti duke ju përshtatur ndryshimeve që vijnë si propozime të njëjësive si dhe duke ju përshtatur ndryshimeve të tregut. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” ka kaluar procesin e riorganizimit në vitin 2020. <i>Evidenca 15 përmbledhëse e tabelave për programin Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i> <i>Evidenca 13 Plani mësimor Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i>
Konkluzione	Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë. Rekomandohet përshtatja e kurrikulës me profilin në rastin e profilit “Administratë Publike”. Rekomandohet gjithashtu familjarizimi i personelit akademik me procedurën e administrimit dhe përditësimit të programeve të lëndëve. Ky kriter përmbushet kryesisht.



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Përmbajta e programeve të studimit, shpërndarja e lëndëve dhe shembujt praktik të trajtuar gjatë të gjithë ciklit të studimit, mundësojnë për studentët e Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane, thellim të njohurive dhe aftësive të tyre në lidhje me kërkesat e tregut të punës. Programi Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” duke zhvilluar aftësi teknike, ndërpersonale dhe konceptuale, mundëson punësimin e të diplomuarve në mënyrë të veçantë edhe në përputhje me emërtimin e tij në sektorin publik, dhe atë privat, në fushën e shkencave politike dhe administrative, gjithashtu konform Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë”. <i>Evidenca 13 Plani mësimor Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje”</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, është hartuar në bazë të Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të studimeve, është organizuar të ketë shtrirje përgjatë 6 semestrave me kohëzgjatje normale 15 javë. Ndërtimi i kurrikulave harmonizon disiplinat me objektivat formuese në funksion të aftësive profesionale të studentëve. <i>Evidenca 13 Plani mësimor Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje”</i>
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Në strukturën e programit të studimit evidentohen objektivat formuese të studimit të cilat janë në përputhje me përcaktimet ligjore. Lëndët që ky program studimi përmban janë në përputhje me drejtimin dhe profilin e studimit. Ngarkesa mësimore për këtë program studimi është 4500 orë mësimore me një total (180 ECTS), duke e përafëruar këtë program studimi me programe të ngjashme ndërkombëtare.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	ndërkombëtare. Kurrikulat sigurojnë mobilitet i cili reflektohet në bashkëpunimin në kuadër të Erasmus +. <i>Evidenca 5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integrimit dhe Qeverisje"</i> <i>Evidenca 14 Analiza e tregut të punës</i>
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Kurrikula e programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integrimit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike" garanton pajisjen e studentëve me njohuritë e nevojshme teorike dhe praktike në lidhje me metodat, teknikat dhe instrumentet që u vijnë në ndihmë për të arritur objektivat e synuara të programit të studimit. Veprimtaritë formuese në këtë program studimi mundësojnë transferimin e studimeve, mobilitetet dhe punësimin në përfundim të studimeve. <i>Evidenca 4 Plani strategjik i zhvillimit UMSH</i> <i>Evidenca 5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integrimit dhe Qeverisje"</i> <i>Evidenca 13 Plani mësimor Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integrimit dhe Qeverisje"</i>
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Humane/DSHPMN personeli akademik i tij përmirëson vazhdimisht syllabuset. Syllabuset përgatiten duke respektuar formatin tip dhe lirinë akademike. Syllabuset janë të përditësuar në mënyrë të vazhdueshme me qëllim që studentët të përfitojnë njohuritë e nevojshme nga secila lëndë e zhvilluar në këtë program studimi, në përshtatje me tregun e punës. Rekomandohet që personeli akademik i departamentit të jetë më familjar me procedurën e përditësimit, ndryshimit, përmirësimit dhe administrimit të programeve të lëndës. <i>Evidenca 13 Plani mësimor Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integrimit dhe Qeverisje"</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), përmes programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integrimit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike", siguron një përmbajtje akademike të strukturuar, e cila garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Programi është hartuar në përputhje me standardet kombëtare dhe evropiane, duke kombinuar aspektin teorik dhe praktik, me qëllim përgatitjen e studentëve për sfidat e tregut të punës dhe sektorit publik. Nëpërmjet lëndëve të specializuara dhe metodave

	bashkëkohore të mësimdhënies, studentët fitojnë njohuri të thelluara mbi politikat publike, administratën, proceset e integritit dhe qeverisjen, si dhe zhvillojnë aftësi analitike, vendimmarrëse dhe menaxheriale, të domosdoshme për karrierën e tyre profesionale. Në përputhje me objektivat për programe studimi të ciklit të dytë, programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara shkencore teorike e praktike. Ky program studimi i cili ka synim që të përgatisë specialistë të lartë të aftë në fushën e shkencave politike dhe administratën publike, është i hartuar në mënyrë të tillë që i krijon mundësi studentëve të regjistruar të përfitojnë dijet, aftësitë dhe kompetencat e thelluara të nevojshme për të hyrë në tregun e punës. Rekomandohet që kurrikulat të përputhen me nevojat e formimit të diplomës veçanërisht në rastin e profilit “Administratës Publike”.			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	DSHPMN, ka mundësuar që përmes përmbajtjes së programeve të studimit studentët të kenë mundësi të vijimësisë së studimeve. Nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkruara me partnerët, nxitet dhe mundësohet punësimi i tyre duke iu përshtatur nevojave të tregut. Përmbajtja e programit të studimit mundëson integrimin e praktikës me teorinë. Niveli i punësimit ë këtij programi tregon se ai është në përputhje me kërkesat e tregut, si dhe përmbajtja e tij dëshmon për plotësimin e dijeve të studentëve.			
Konkluzione	<i>Struktura dhe organizimi i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxëniet, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Ky kriter përmbushet plotësisht</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) siguron që programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecures së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, të jetë në përmirësim të vazhdueshëm dhe të përshtatet me kërkesat dinamike të tregut të punës. Për këtë arsye, njësitë përgjegjëse të programit zhvillojnë konsultime të rregullta me institucionet partnere, të diplomuarit dhe aktorë të tjerë nga sektori publik dhe privat, duke marrë në konsideratë propozimet dhe rekomandimet e tyre. Ky bashkëpunim ndihmon në përditësimin e përmbajtjes akademike, integritimin e moduleve praktike dhe zhvillimin e aftësive që kërkohen nga tregu i punës, duke siguruar një përgatitje cilësore dhe të konkurrueshme për studentët. Për përshtatjen e mirë të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse të Universitetit Mesdhetar i Shqipërisë merr në konsideratë propozimet e bashkëpunëtorëve si me të cilët ka marrëveshje lidhur me administrimin e programeve të studimit dhe përshtatjen e tij me tregun e punës.. Ecuria e programeve të studimit ndiqet nga departamenti dhe fakulteti duke përfshirë edhe mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës si dhe feedback-un nga studentët. <i>Evidenca 14 Analiza e tregut të punës</i> <i>Evidenca 9 Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UMSH</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përfshin studentët në vendimmarrjen dhe në çështje madhore të institucionit. Studentët janë pjesë e organeve vendimmarrëse dhe kolegjiale të Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, si Senati Akademik si dhe janë pjesë aktive e diskutimeve. Mbahen lidhje me studentët e diplomuar. Feedback-u dhe informacioni që vjen nga studentët pjesë e ALUMNI si dhe partnerët me të cilët Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka marrëveshje bashkëpunimi ku studentët realizojnë edhe praktikant profesionale, është një burim nga i cili Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë realizon përmirësimin në programet e studimit dhe kurrikulat.
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në bashkëpunim me partnerët realizon përmirësime në programin e studimit dhe në syllabuset respektive. Departamentit vjel ide dhe nevoja konkrete nga ana e këtyre institucioneve në mënyrë që të përshtatë programet studimore sa më shumë të jetë e mundur me nevojat konkrete të administratës publike, në nivel qendror dhe nivel lokal. Eksperiencat me universitetet perëndimore japin një kontribut të rëndësishëm në përmirësimin e programit dhe në sigurimin e mobilitetit të tij.

mjekësisë) dhe institucione publike e private.				
Konkluzione	<i>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre. Ky Kriter përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënës, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarat, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikatat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e organizimit të procesit mësimor përfshijnë: • Leksionet – për të transmetuar njohuritë themelore dhe teorike; • Seminarat – për të inkurajuar diskutimin dhe analizën kritike; • Detyrat e kursit dhe estetë – për zhvillimin e të menduarit analitik dhe kritik; • Projektet – për të nxitur punën në grup dhe zgjidhjen e problemeve; • Praktikatat profesionale – për përgatitjen e studentëve për tregun e punës; • Orët e hapura – për diskutime me ekspertë dhe personalitete të fushës; • Çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni, në përputhje me standardet akademike. Ky model mësimor synon të zhvillojë tek studentët njohuri të avancuara, aftësi analitike dhe kompetenca praktike, duke i

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	përgatitur ata për sfidat profesionale në administratën publike dhe politikën e integritetit. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përdor metoda bashkëkohore të mësimdhënies. Aktualisht për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” integrohen dy metoda të mësimdhënies: aspekti teorik ku përfshihen leksionet dhe aspekti praktik ku përfshihen seminarët detyrat e kursit etj. Nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë motivohet të puna në mënyrë të pavarur e studentit. Në syllabus evidentohen format e miratuara të mësimdhënies nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. <i>Evidenca 13 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i> <i>Evidenca 19 Leksione të hapura DSHPMN</i>
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) garanton një mjedis akademik gjithëpërfshirës dhe fleksibël në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Personeli akademik angazhohet për të respektuar dhe për t’iu përgjigjur larmisë dhe nevojave të studentëve, duke përdorur metoda të ndryshme mësimdhënieje dhe mësimnxënijeje, të përshtatura për stile të ndryshme të të nxënit. Në këtë kuadër, ofrohen: • Leksione interaktive dhe seminare që inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve; • Punë individuale dhe në grup, për të zhvilluar aftësi analitike dhe bashkëpunuese; • Mësimdhënie e asistuar nga teknologjia, duke përfshirë platformat online dhe burimet digjitale; • Orë konsultimi dhe mentorim individual, për të mbështetur nevojat specifike të studentëve; • Praktika profesionale dhe projekte, që lidhin teorinë me aplikimin në terren; Kjo qasje synon të krijojë një ambient të favorshëm mësimor, duke përmirësuar cilësinë e arsimit, përvojën akademike dhe përgatitjen profesionale të studentëve. Realizimi i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” ka në dispozicion të gjithë infrastrukturën e nevojshme për realizuar në mënyrë të suksesshme mësimdhënien. Mjediset në të cilat zhvillohet mësimi janë të pajisura me mjetet e duhura për zhvillimin normal të mësimin.



	Personeli akademik sipas rastit përdor mjete alternative për të realizuar një mësimdhënie sa më efikase dhe në funksion të objektivave të programit të studimit. Një shembull i mirë është edhe përshtatja e menjëhershme e UMSH me situatën e mësimdhënies online gjatë pandemisë.
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) angazhohet për të mbështetur personelin akademik në përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencave didaktike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Në këtë kuadër, institucioni ofron: • Trajnime dhe seminare të rregullta për zhvillimin profesional të stafit akademik; • Workshop-e për metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë në edukim; • Shkëmbime akademike dhe partneritete me universitete dhe institucione të tjera për të ndarë praktikën më të mirë; • Mbështetje për kërkimin shkencor, me qëllim përmirësimin e materialeve didaktike dhe metodave pedagogjike; • Vlerësim të vazhdueshëm të performancës akademike për të identifikuar mundësi për përmirësim dhe inovacion në mësimdhënie. Këto masa synojnë të sigurojnë një cilësi të lartë akademike, duke iu përgjigjur nevojave të studentëve dhe kërkesave të tregut të punës me një arsim bashkëkohor dhe të orientuar drejt rezultateve. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë mundëson përmirësimin e formimit të personelit akademik duke ju ofruar mundësi trajnime dhe kualifikimi brenda institucionit por edhe nga institucione të tjera. Nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë realizohen gjithashtu seanca trajnime periodike mes personelit akademik dhe studentëve në funksion të efikasitetit të procesit të mësimdhënies. <i>Evidenca 4 Plan i strategjik i zhvillimit UMSH</i> <i>Evidenca 25 Programi i trajnimeve 2022-2023</i> <i>Evidenca 30 Manual i përdorimit të platformave elektronike</i> <i>Evidenca 32 Evidenca të lëvizjes së stafit akademik dhe administrativ</i>
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH), në kuadër të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, siguron që personeli akademik të jetë i kompetent dhe i angazhuar në mënyrë aktive për shpjegimin e njohurive dhe koncepteve në mënyrë të qartë dhe efikase.

në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Në këtë drejtim, stafi akademik përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive, të cilat përfshijnë: • Diskutime dhe analiza kritike në grup, duke inkurajuar mendimin krijues dhe autonominë e studentëve; • Përfshirje aktive të studentëve në mësim, për të stimuluar ndjekjen e temave me fokus në studentin si aktor kryesor në procesin mësimor; • Kjo qasje promovon mendimin kritik dhe zhvillon aftësinë e studentëve për të qenë të pavarur dhe të përgjegjshëm në zgjidhjen e problemeve dhe ndërtimin e ideve të reja. Përveç mësimdhënies efektive, personeli akademik siguron gjithashtu udhëheqje dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët, duke krijuar një mjedis të respektit të ndërsjellë dhe bashkëpunimi. Ky mjedis i shëndetshëm dhe mbështetës është i rëndësishëm për zhvillimin e marrëdhënieve profesionale dhe përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në politikat e tij të përzgjedhjes së personelit akademik promovon përfshirjen e lektorëve me titujt dhe gradat respektive për tu përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Gjithashtu Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë përpaket të bëjë pjesë të institucionit brezin e specialistëve të shkolluar në vendet perëndimore duke i dhënë një mundësi më shumë eksperiencave bashkëkohore të mësimdhënies të bëhen pjesë e institucionit dhe e praktikave që ai përdor dhe adapton për të administruar procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Suksesi i këtyre proceseve reflektohet edhe në vlerësimet e studentëve si pjesë e vlerësimit të mësimdhënies. Sipas rastit Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë realizon trajnime kur është e nevojshme për të ndihmuar në këtë proces si dhe për të ndihmuar në adaptimin e teknikave inovative. Metodatat e mësimdhënies dhe të kontrollit të dijeve janë të pasqyruara në syllabuset repektive të miratuara nga departamenti përkatës. <i>Evidenca 13.3 CV të stafit akademik të programit akademik të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i> <i>Evidenca 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti.</i>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si pjesë integrale e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane administron programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e

mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” në drejtim të veprimtarisë akademike, kërkimore shkencore dhe administrative. Njësia kryesore dhe njësia bazë janë përgjegjëse të për menaxhimin e cilësisë së programit të studimit. Drejtuesi i njësive kryesore kontrollon cilësinë e procesit mësimor. Bazuar në feedback-un e marrë nga instrumente të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë realizohet edhe procesi i përmirësimit të performancës. <i>Evidenca 29 Procedura e punës me fokus grupet</i> <i>Evidenca 27 Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti</i> <i>Evidenca 28 Plani i monitorimit DSHPMN</i>
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) ka krijuar dhe organizuar struktura dhe njësitë në nivel institucional që kanë si qëllim promovimin e përmirësimit të vazhdueshëm të mësimdhënies dhe sigurimin e cilësisë së arsimit. Këto struktura janë të dedikuara për të koordinuar dhe bashkërenduar aktivitetet mes njësive kryesore/bazë të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, duke përfshirë aktivitete që lidhen me përmirësimin e metodave dhe praktikave të mësimdhënies. Në këtë kuadër, institucionet përgjegjëse: • Mbështesin zhvillimin e metodave të reja dhe inovative të mësimdhënies, të cilat janë të përshtatura për kërkesat e kohës dhe mundësitë e teknologjisë së re; • Trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për të përmirësuar aftësitë didaktike dhe për të zbatuar metodat e reja të mësimdhënies, si përdorimi i mjeteve digjitale, teknologjisë së informacionit, dhe metodologji të orientuara në studentë; • Koordinimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve për të siguruar një qasje të përbashkët dhe të qëndrueshme në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike dhe rritjen e kapaciteteve të mësimdhënies. Kjo strukturë mbështet një mjedis akademik të shëndetshëm dhe inovativ, ku zhvillohen aftësi të reja dhe ku studentët përgatiten për të përballuar kërkesat e tregut të punës dhe për të kontribuar në zhvillimin e shoqërisë. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë mundëson përmirësimin e formimit të personelit akademik duke ju ofruar mundësi trajnimi dhe kualifikimi brenda institucionit por edhe nga institucione të tjera. Nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë realizohen gjithashtu seanca trajnimi periodike mes personelit akademik dhe studentëve në funksion të efikasitetit të procesit të mësimdhënies.

	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë gjithashtu ka institucionalizuar Komisionin e Promovimit të personelit Akademik. <i>Evidenca 16 Rregullore e organizimit dhe punës së NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 27 Formular i vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca 33 Plani i punës NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 25 Programi i trajnimeve 2022-2023</i> <i>Evidenca Plani i monitorimit DSHPMN</i>			
Konkluzione	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë garanton procesin e të nxënës dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve. Ky kriter përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Mënyrat e kontrollit të dijeve dhe testimit të njohurive dhe aftësive profesionale për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” janë të përcaktuara qartë në Rregulloren e Njësive bazë dhe asaj kryesore ashtu siç edhe në rregulloren e programit të studimit. Përveç formave klasike në këtë program studimi vlerësohet edhe aktivizimi, detyrat e kursit, projektet, testimet etj. <i>Evidenca 7 Rregulle e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje”</i> <i>Evidenca 20 Udhëzues për studentët</i>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” në programet e lëndëve dhe disiplinave respektive përcakton qartë mënyrat e vlerësimit. Ky informacion i bëhet i ditur studentit që në orën e parë të lëndës përkatëse nga personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien e asaj lënde, shpërndarja e këtij informacioni realizohet nga pedagogu apo nga koordinatori në rast se është nevoja. Programet e lëndëve janë të publikuara edhe në portalin e Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë

	në sitin e UMSH. Pra, studentëve u prezantohet struktura e lëndëve dhe përqindjet e pikëve për të gjithë elementët. <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 20 Udhëzues për studentët</i> <i>Evidenca 21 Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i>
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Studentët në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” vlerësohen ndërmjet provimeve të ndërmjetme, detyrave të kursit, projekteve, rasteve të studimit dhe provimit përfundimtar. Siç u shpreh më lart mënyra e vlerësimit është e shprehur në syllabusin e lëndës dhe u bëhet e ditur studentëve. <i>Evidenca 21 Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin</i>
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Personeli akademik i DSHPMN përdor metodologji mësimdhënie të larmishme. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) siguron që njësia bazë dhe personeli akademik të kryejnë vlerësime dhe përmirësime periodike të formave dhe metodave të mësimdhënies në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Ky proces përmirësimi bazohet në: • Përdorimin e vlerësimeve nga studentët për metodat e mësimdhënies, duke analizuar sugjerimet e tyre për të përmirësuar efektivitetin e procesit mësimor; • Rishikime periodike të metodave didaktike, duke përfshirë teknika interaktive, digjitale dhe hulumtuese për të nxitur angazhimin e studentëve; • Organizimin e takimeve dhe forumeve të hapura me studentët për të diskutuar mbi përvojën e tyre akademike dhe për të integruar sugjerimet e tyre në përmirësimin e kurrikulës; • Implementimin e risive pedagogjike bazuar në praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në mësimdhënie dhe mësim nxënie. Përmes kësaj qasjeje gjithëpërfshirëse, UMSH garanton një proces arsimor cilësor, dinamik dhe të përshtatshëm me nevojat e studentëve dhe kërkesat e tregut të punës. Aplikimi i formave tradicionale dhe metodave inovative kanë për qëllim krijimin e autonomisë së studentit, interaktivitetit të procesit të m procesit të

	mësimdhënies, dhe nxitjes së kreativitetit dhe kuriozitetit të të mësuarit.			
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) siguron një mjedis të hapur dhe fleksibël akademik, duke ofruar metoda të shumëllojshme dhe inovative pedagogjike në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Në këtë kuadër, UMSH: • Përdor teknika të ndryshme mësimdhënieje, përfshirë leksionet interaktive, punët në grup, studimet e rasteve, diskutimet akademike dhe platformat digjitale për mësim online e hibrid; • Siguron përshtatshmërinë e metodave me objektivat formues, duke i orientuar studentët drejt aftësive analitike, kritike dhe të pavarura, të cilat janë thelbësore për tregun e punës; • Promovon autonominë e studentëve, duke inkurajuar qasjen e tyre proaktive në procesin e të nxënit dhe duke i ndihmuar të zhvillojnë aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe vendimmarrjen e pavarur; • Siguron mbështetje dhe udhëzim nga mësimdhënësit, duke ndërtuar një marrëdhënie respekti të ndërsjellë ndërmjet stafit akademik dhe studentëve, për një përvojë akademike më të pasur dhe efikase. Kjo qasje garanton që studentët e UMSH të jenë të përgatitur për sfidat profesionale, duke kombinuar njohuritë teorike me aftësitë praktike, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe pritshmëritë e punëdhënësve.			
Konkluzione	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre. DSHPMN nxit metodat e përshtatshme të mësimdhënies dhe i përmirëson në mënyrë periodike duke u bazuar edhe në procesin e vlerësimit. Ky kriter përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	Format e vlerësimit nga ana cilësore dhe sasiore përcaktohen qartë në rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, të

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si dhe të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Pedagogu i lëndës realizon vlerësimin e studentit mbi njohuritë dhe dijet e fituara sistematikisht dhe ky vlerësim përfshihet në vlerësimin përfundimtar. Komponentët e vlerësimit janë: testime periodike, detyra kursi që dorëzohen në javën e 13-të apo 14-të, provimi përfundimtar mbi bazën e materialeve të trajtuara gjatë zhvillimit të lëndës. Përqindja e ndaj totalit të vlerësimit përfundimtar të këtyre komponentëve përcaktohet në syllabusin e lëndës. <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 21 Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) ka implementuar sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, duke siguruar një proces transparent, të drejtë dhe të pandikuar për studentët e programit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Në këtë kuadër, UMSH nxit në: • Përdorimin e platformave digjitale për testimin dhe vlerësimin, të cilat mundësojnë administrimin e provimeve në mënyrë të sigurt dhe të standardizuar; • Zbatimin e mekanizmave kundër abuzimeve, përmes sistemit të identifikimit elektronik, rregullave të qarta dhe monitorimit të procesit të vlerësimit; • Sigurimin e transparencës maksimale, duke ofruar akses studentëve në rezultatet dhe komentet e vlerësimit në kohë reale përmes platformave online; • Përmirësimin e cilësisë së vlerësimit, duke ofruar larmi metodash të matjes së njohurive, si teste me alternativa, ese të strukturuar dhe detyra praktike. Përdorimi i teknologjisë në procesin e vlerësimit rrit besueshmërinë, objektivitetin dhe efektivitetin e sistemit akademik, duke garantuar një mjedis të drejtë dhe të barabartë për të gjithë studentët. Disa nga format janë formatet elektronike (quiz assignment) google form etj. <i>Evidenca 30 Manual i përdorimit të platformave elektronike</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në	Format e vlerësimit përfundimtar të lëndës mire përcaktohen në instrumentet ligjorë dhe syllabuset për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile

përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	“Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” dhe vlerësimi përfundimtar realizohet mbi bazën ligjore dhe në përputhje me syllabusin si dhe akteve rregullative të departamentit. Tezat e provimit përgatiten nga titullari i lëndës dhe miratohen nga përgjegjësi i DSHPMN të paktën dy ditë para provimit. Provimet realizohen me komisione prej dy anëtarësh. <i>Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i> <i>Evidenca 8 Rregullore e DSHPMN</i> <i>Evidenca 21 Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Vlerësimi i dijeve dhe njohurive realizohet nga pedagogu i lëndës i cili vlerësimin e tij e shoqëron dhe me komentet respektive sipas rastit, vlerësimi dhe komentet respektive realizohen nga pedagogu për çdo pyetje deri në arritjen e një vlerësimi përfundimtar. Pedagogu i lëndës ndërmjet ballafaqimit të rezultateve të procesit të vlerësimit duke përfshirë të gjithë elementët e vlerësimit të njohurive bën transparent rezultatet e studentit, përmirësimet që duhet të bëjë dhe rezultatin përfundimtar. <i>Evidenca 7 Rregullore e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i> <i>Evidenca 8 Rregullore e DSHPMN</i> <i>Evidenca 21 Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i> <i>Evidenca 22 Model format teze</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në rregulloren e tij, Statutin, rregulloren e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, rregulloren e Departamentit të Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare si dhe rregulloren e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” përcaktohet kuadri ligjor i shmangjes së plagjiaturës/kopjimit në detyra dhe provime. Nga ana operative ky proces sipas rastit ndiqet nga pedagogu i lëndës, bashkëpunuesve në provim apo komisioneve. Ky proces është objekt raportimi dhe shqyrtimi dhe nga Këshilli i Etikës. <i>Evidenca 9 Kodi i Etikës</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>




Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë janë krijuar instrumentet ligjorë dhe praktike për të vlerësuar me meritokraci dhe drejtësi dijet dhe aftësitë profesionale të studentit të programit të studimeve Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Ky proces mbikqyret nga të gjitha hallkat akademike dhe administrative të njësive përkatëse. Studenti ka të drejtë të sqarohet për paqartësitë që ka lidhur me vlerësimin e tij ashti siç edhe ka të drejtë të ankimojë rezultatin. Ndërmjet Sistemit të menaxhimit të Studentit personeli akademik pasqyron online rezultatet e studentit si dhe reflekton procesverbalin. UMSH aplikon sektretimin e tezadve të provimit. <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 21 Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i>			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” siguron seancat ballafaqese dhe sqaruese të rezultateve të provimit si dhe garanton të drejtën e ankimit ndërmjet bazës ligjore në fuqi. <i>Evidenca 21 Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i>			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Sipas rregullores studenti ka të drejtë të ankimojë vlerësimin e bërë në adresë të tij. Ankimet dhe kontestimet e rezultateve depozitohen në shqyrtohen fillimisht nga Dekani, i cili përcakton merr vendim lidhur me kërkesën e studentit dhe sipas rastit vendos nëse provimi do të rivlerësohet apo jo nga një komision i posaçëm. Ky proces dokumentohet dhe ruhet sipas procedurës përkatëse. <i>Evidenca 21 Udhëzimi mbi procedurat dhe afatet e sezonit të provimeve dhe plani i punës për sezonin.</i>			
Konkluzione	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit. Ky kriter përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) siguron që programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, të ofrojë një qasje të thelluar akademike dhe profesionale, duke garantuar: Thellimin e njohurive për konceptet dhe teoritë kryesore në shkencat politike dhe administrative, duke integruar perspektiva kombëtare dhe ndërkombëtare; Zhvillimin e aftësive analitike dhe praktike, duke u fokusuar në zgjidhjen e problemeve komplekse të administratës publike dhe politikave të integritit; Përvetësimin e kompetencave specifike profesionale, përmes studimeve të rasteve, simulimeve dhe praktikave profesionale pranë institucioneve publike dhe organizatave ndërkombëtare; Nxitjen e mendimit kritik dhe autonomisë në vendimmarrje, duke përdorur metoda mësimdhënieje interaktive dhe bashkëpunuese; Përshtatshmërinë me kërkesat e tregut të punës, duke siguruar një program të azhurnuar sipas zhvillimeve më të fundit akademike dhe profesionale. Ky program synon të përgatisë profesionistë të aftë, të cilët mund të kontribuojnë në administratën publike, politikëbërje dhe institucione ndërkombëtare, duke u bazuar në njohuri të thelluara, aftësi praktike dhe etikë profesionale. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” është ndërtuar në mënyrë të tillë që respekton ndarjen ndërmjet kategorive të lëndëve si dhe për nga përmbajtja mundëson një formim i cili garnaton thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale të përgjithshme dhe specifike shkencore të studnetëve. <i>Evidenca 5 Strategjia e zhvillimit të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Pjesë integrale e kurrikulave të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” janë edhe disiplina të formimit të koncepteve bazë në fushën e Ekonimisë, Filozofisë, Sociologjisë dhe Komunikimit dhe marrëdhënieve me Publikun që ndihmojnë në rritjen profesionale por edhe krijimin e një backgroundi human social dhe komunikativ. Gjithashtu edhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



	lëndë që aftësojnë studentin në teknologji informacioni, gjuhë e huaj apo të formimit ndërkulturor, social dhe shkencor. <i>Evidenca 13 Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidenca 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti.</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë (UMSH) siguron një proces të strukturuar dhe të vazhdueshëm vlerësimi të kompetencave dhe aftësive që studentët fitojnë gjatë programit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Në këtë kuadër, UMSH: • Analizon dhe shqyrton rezultatet e të nxëniet në përfundim të çdo lënde, duke krahasuar objektivat fillestare me përvetësimin real të studentëve; • Siguron një qasje sistematike në vlerësimin e kompetencave, përmes analizës së syllabus-it dhe përmbylljes së programit mësimor; • Personeli akademik orienton studentët për mënyrat më efektive të zbatimit të njohurive dhe aftësive të fituara në kontekste profesionale; • Diskuton çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë kursit, duke ndihmuar studentët të përgatiten për detyrimet përmbyllëse, si provimet finale, punimet e kursit dhe projektet praktike; • Ndihmon studentët të kuptojnë lidhjen mes teorisë dhe praktikës, duke i përgatitur për sfidat e tregut të punës dhe kërkesat e sektorit publik e privat. Ky proces siguron rritjen e cilësisë akademike, duke e bërë të mundur që studentët jo vetëm të përvetësojnë njohuri të thelluara, por edhe t'i zbatojnë ato në mënyrë efektive në fushën e tyre profesionale. Personeli akademik i programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” respekton parashikimet e paraqitura në syllabus. Në këtë proces personeli akademik monitoron realizueshmërinë me sukses të objektivave të lëndës si dhe planifikimeve të programit të lëndës. <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lëndëve të ofruara për vitin akademik 2023-2024</i>

	<i>Evidenca 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti.</i>			
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ndërmjet konceptimit dhe metodologjisë së hartimit të programeve të lëndës si dhe monitorimit strukturor të këtij procesi ka mundësuar realizimin e mesimdhënies në bazë të kompetencave që duhen fituar konkretisht në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. Ky synim i institucionalizuar i syllabuse konkretizohet dhe në punën e personelit akademik në materializimin e syllabusit në punën që realizojnë gjatë mësimdhënies me studentët. Në syllabuset respektive të programit të studimit por edhe në rregulloret respektive promovohet krijimi i klimës së përshtatshme, ndërthurja e formave të mësimdhënies etj.			
	<i>Evidenca 53 Strategjia e Ndërkombëtarizimit</i> <i>Evidenca 19 Leksione të hapura DSHPMN</i>			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Nga strukturat e Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në bashkëpunim me studentët realizohen evente të cilat angazhojnë personelin akademik dhe studentet në aktivitete të tilla kurrikulare dhe ekstrakurrikulare, trajnime, workshope, leksione të hapura etj.			
	<i>Evidenca 19 Leksione të hapura DSHPMN</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Detyrimet përmbyllëse të studentit të programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” realizohen duke u bazuar tek rregullorja e përgjithshme institucionale. Udhëzuesi i provimit të formimit gjithashtu jep një informacion të mjaftueshëm lidhur me procedurat e diplomimit. Informacionin lidhur me detyrimet përmbyllëse si dhe realizimin e provimit të formimit studenti e merr pranë koordinatorit të programit, sekretarisë mësimore dhe faqes zyrtare të UMSH <i>Evidenca 7 Rregullore e programit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”</i> <i>Evidenca 17 Pyetjet orientuese për provimin e formimit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Detyrimet përmbyllëse përcaktohen në rregulloret përkatëse, studentët e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” marrin informacionin e nevojshëm nga strukturat akademike, administrative dhe ndihmës akademike të Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Parashikimet ligjore lidhur me komisionin e provimit të formimit janë të përcaktuara nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Teza e provimit të formimit sipas përcaktimeve përbëhet nga 40% pyetje të disiplinave të formimit të përgjithshëm dhe 60% disiplina të specialitetit. Studentët udhëzohen ndërmjet një programi orientues për këtë provim si dhe literaturën përkatëse e cila depozitohet paraprakisht në bibliotekën e UMSH. Komisioni i provimit të formimit i përcaktuar nga departamenti harton dhe administron tezat e provimit të formimit e cila hartohet nga fondi i pyetjeve të depozituara nga departamenti.
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse	Për të përcaktuar proceduralisht procesin e diplomimit për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ka përcaktuar kuadrin ligjor në rregulloren e programit të studimit, rregulloren e DSHPMN si dhe në aktet e tjera ligjore. Procesi i diplomimit në programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” realizohet ndërmjet provimit të formimit. <i>Rekomandohet hartimimi i një udhëzuesi të dedikuar për provimin e formimit, i cili citohet në RVB por nuk gjehet në evidencat e depozituara.</i>

punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	<i>Evidenca 7 Rregullore e programit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike".</i> <i>Evidenca 17 Pyetjet orientuese per privimin e formimit</i>
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Struktura te akademike, ndihmës akademike dhe administrative të Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë pajisin studentin e programit të studimit të Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike" me materialet e domosdoshme per realizimin e praktikave profesionale dhe diplomimit/provimit të formimit si dhe asiston studentët në realizueshmërinë praktike të provimit të formimit.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Siç u përmend edhe më lart procedura e diplomimit në Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë është parashikuar të realizohet me provim formimi të administruar nga një komisioni të ngritur. Në përfundim të procesit komisioni vlerëson me notë studentin <i>Evidenca 7 Rregullore e programit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike"</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë në përfundim të studimeve në programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike" pajis studentët me diplomë dhe suplementin përkatës të programit të studimit. Studentë mund të pajisen edhe me materiale të tjera të programit të studimit të tilla si syllabuset e lëndëve të realizuara. <i>Evidenca 7 Rregullore e programit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike"</i> <i>Evidenca 36 Modeli i diplomës për programin Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike"</i> <i>Evidenca 27 Modeli i suplementit të diplomës për programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike"</i> <i>Evidenca 8 Rregullore e FDSH</i>
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria mësimore e Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ruan dhe administron dokumentacionin e studentit të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike. Kur studenti diplomohet/transferohet apo cregjistrohet dosja e tij arkivohet. Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë arkivon

	dokumentacionin respektiv bazuar në Ligjin 9154 date 06.11.2003"per arkivat' si dhe rregulloren e brendeshme per funksionimin e arkivit te Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë. Studenti ka të drjetë të kërkojë informacion zyrtar lidhur me studimet e tij dhe këto i vihen ne dispozicion nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë.			
Konkluzione	<i>Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integrimit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike" dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm. Ky kriter përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me	Personeli akademik që mbulon programin e studimit përbëhet nga personel akademik efektiv dhe me kontratë. Nga dokumentacioni, numri i personelit akademik në Departamentin e Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare për periudhën 2022-2023 përfshin 11 personel akademik efektiv dhe 5 personel akademik me kontratë. PAE në këtë njësi mbulon ngarkesën mësimore sipas përcaktimeve ligjore. Sipas nevojave angazhohen dhe PAK, sipas nje planifikimi që kryet çdo fillim viti akademik. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

Tituj/ grada	2021 – 2022		2022 – 2023		2023 – 2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	1	-	1	-
Prof. Asoc.	2	-	2	-	2	-
Dr./PhD.	5	1	6	4	5	4
Msc.	2	2	2	1	2	1
Totali	9	3	11	5	10	5

Personeli i angazhuar në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” përfshin:

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	1	-	1	-	2	-
Prof. Asoc.	-	-	2	-	2	-
Dr./PhD.	5	1	11	1	11	3
Msc.	2	-	2	1	3	1
Totali	8	1	16	2	18	4

Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH

Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA

Evidenca 8 Rregullore DSHPMN

Permbledhje e tabelave

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

	Bazuar evidences “Përmbledhje e Tabelave” vihet re se për vitin akademik 2023-2023, PAE ka mbajtur 2055 orë, ndërkohë PAK 105 orë. <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i> <i>Evidenca 8 Rregullore DSHPMN</i> <i>Përmbledhje e tabelave</i>
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Evidencat tregojnë se ka një qëndrueshmëri sa i takon personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit. Ka një praktikë të konsoliduar dhe të qëndrueshme në menaxhimin dhe angazhimin e stafit akademik për programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”. <i>Përmbledhje e tabelave</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	UMSH ka përcaktuar rregullime të qarta dhe të detajuara për proceset e përzgjedhjes dhe rekrutimit të personelit akademik që do të angazhohet në programin e studimit. Kërkesat për rekrutim vijnë nga njësi bazë. Përzgjedhja bëhet me konkurs nga një komision ad hoc. Procedurat e punësimit përfundohen me lidhjen e kontratave të punës për të gjithë personelin akademik, duke përfshirë çdo kategori të stafit, si ata me kontratë dhe ata efektivë. Rregullimet në lidhje me kontratën e punës, kushtet dhe kohëzgjatjen, të drejtat dhe detyrimet e personelit akademik janë të detajuara në Statutin e Universitetit si dhe referojnë në Kodin e Punës, Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Vlerësimi bëhet në bazë të kriterëve të përgjithshme (formimi, niveli i kualifikimit) dhe specifike (eksperienca, përputhje me natyrën, stukturën dhe modulet). <i>Evidenca 34 Përmbledhje e procedurës së rekrutimit</i> <i>Evidenca 35 Kontrata Pedagog i Brendshëm</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore,	Për zbatimin e këtij programi studimi, institucioni ka angazhuar një numër të mjaftueshëm personeli ndihmës akademik, i cili luan një rol kyç në mbështetjen dhe lehtësimin e procesit mësimor. Ky personel kontribuon në mënyrë efektive në administrimin dhe zhvillimin e veprimtarive akademike, duke siguruar një mjedis të përshtatshëm për mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Rregulloret dhe aktet normative të institucionit përcaktojnë qartë kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen dhe punësimin e personelit

sipas natyrës specifike të programit të studimit.	ndihmës akademik. Procesi i rekrutimit është i strukturuar dhe zhvillohet përmes procedurave të hapura dhe transparente të konkurrimit, duke përfshirë një vlerësim të plotë të kandidatëve nga strukturat përkatëse. Këto mekanizma sigurojnë që në pozicionet e personelit ndihmës akademik të angazhohen individë të kualifikuar dhe me aftësitë e nevojshme për të mbështetur efektivisht procesin akademik dhe administrativ. Gjithashtu, institucioni synon të garantojë qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e kësaj kategorie personeli, duke zbatuar masa që sigurojnë zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe përmirësimin e kushteve të punës në përputhje me nevojat e institucionit dhe standardet akademike. <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 34 Permbledhje e procedures se rekrutimit</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	UMSH menaxhon dhe arkivon në mënyrë të strukturuar të dhënat që lidhen me burimet njerëzore të angazhuara në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë informacion të detajuar mbi statusin e punësimit, rolin dhe përgjegjësitë e secilit anëtar të stafit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe periudhën e angazhimit të tyre për çdo vit akademik apo semestër. Zyra e Burimeve Njerëzore si njësi përgjegjëse administrative, ruan dhe përditëson si të dhënat e stafit akademik, ashtu edhe atij administrativ të angazhuar në programin e studimit. Administrimi i të dhënave të personelit realizohet si në formatin fizik, nëpërmjet dosjeve të personelit, ashtu edhe në formatin elektronik. <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 34 Permbledhje e procedures se rekrutimit</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të	Institucioni ka vendosur bashkëpunime të qëndrueshme me sektorin privat dhe kompanitë për të krijuar mundësi praktike profesionale për studentët. Për këtë qëllim, janë formalizuar marrëveshje bashkëpunimi. Njësia përgjegjëse për programin e studimit disponon burimet njerëzore dhe logjistike të nevojshme për të mbështetur studentët gjatë përvojave praktike, duke ofruar udhëzim, mbikëqyrje dhe orientim profesional. Institucioni është i angazhuar në procesin e mentorimit të studentëve gjatë praktikës. Praktika profesionale është një komponent i rëndësishëm i programit të studimit, duke përfshirë 6 kredite akademike, të cilat përkthehen në 150 orë pune.

tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	<i>Evidenca 10 Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit</i> <i>Evidenca 44 Udhezues per praktikat</i> <i>Permbledhje e tabelave</i>			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ konstaton se praktika zhvillohet në ambientet e universitetit. 4 javët e para zhvillohen nga pedagogu përgjegjës për praktikat, ndërsa pjesa tjetër nga të ftuar ekspert të fushës nga institucione me të cilat UMSH ka nënshkruar marrëveshje. Personeli mbikqyrës ndihmon studentët në përbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe merr pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. <i>Evidenca 44 Udhezues per praktikat</i>			
Konkluzione	GVJ vlerëson se stafi akademik i angazhuar në këtë program studimi plotëson kërkesat e nevojshme për nga numri dhe kualifikimi, duke siguruar një nivel të lartë të mësimdhënies në përputhje me standardet akademike. Njësia përgjegjëse për programin përfshin staf akademik me angazhim të plotë dhe të pjesshëm, të cilët janë të specializuar në fushën përkatëse dhe kanë përvojë të konsiderueshme profesionale. Ky përbërje garanton një mbulim cilësor të procesit mësimor, në përputhje me kërkesat ligjore dhe akademike. Institucioni ka krijuar dhe zbaton politika të qarta për rekrutimin, promovimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Përmes këtyre procedurave, sigurohet qëndrueshmëria dhe rritja profesionale e personelit të përfshirë në realizimin e programit të studimit.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në	GVJ gjykon se program i studimit bazuar numrit të studentëve realizohet në një infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore për studentët dhe stafin akademik. Institucioni ka mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme e të paisura me të gjitha mjetet e nevojshme dhe bashkëkohore për zhvillimin e veprimtarisë së mësimdhënies si salla leksioni dhe

përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	seminaresh, sallë konferencash, aktiviteteve, laboratorë me pajisje kompjuterike, biblioteka, etj. Sipërfaqja totale e godinës është 3860 m2, nga të cilat 6 salla leksionesh, 17 salla seminaresh, 2 laboratorë, 17 zyra për personelin akademik/ndihmës administrativ, 2 biblioteka, 300 m2 hapësirë pushimi. <i>Evidenca 24 Relacion i Verifikimit te godines</i> <i>Evidenca 40 Urdher Higjeno sanitar</i> <i>Evidenca 40 Urdher per zjarrin</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset e dedikuara për zhvillimin e procesit mësimor të këtij programi studimi janë të pajisura me mjetet e nevojshme teknologjike dhe didaktike, të cilat mundësojnë përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Fakulteti i këtij programi disponon salla leksionesh dhe seminare, laboratorë, zyra, dhe hapësira të tjera që mbështesin procesin e mësimdhënies. Të gjitha mjediset janë të pajisura me Wi-Fi, që siguron akses në internet për studentët dhe pedagogët. Po ashtu, sallat e leksioneve dhe seminareve janë të pajisura me teknologji moderne, si videoprojektorë dhe kompjuterë, për të mbështetur një proces mësimor bashkëkohor dhe efikas. <i>Evidenca 24 Relacion i Verifikimit te godines</i>
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ konstaton se pas vizitës në ambientet e IAL-së, mjediset që UMSH ofron përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit. <i>Evidenca 24 Relacion i Verifikimit te godines</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ konstaton se institucioni përmbush këtë kriter duke siguruar laboratorë të teknologjisë së informacionit, të pajisur me PC, videoprojektorë, programe profesionale, software, teams, Microsoft Office 365: Ginger, T translator etj. <i>Evidenca 24 Relacion i Verifikimit te godines</i>
Konkluzione	GVJ konkludon se Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profile "Politikat e Integritetit dhe Qeverisje" dhe "Administratë Publike", ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Mesdhetar i

	<i>Shqipërisë”, realizohet në infrastrukturë dhe mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë akademike për studentët dhe stafin akademik. Mjediset e dedikuara për zhvillimin e procesit mësimor janë të pajisura me mjetet teknologjike dhe didaktike të nevojshme, që mundësojnë përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies. Këto mjedise janë krijuar për të mbështetur objektivat formues të programit dhe ofrojnë mundësi për një mësimdhënie bashkëkohore dhe efikase.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Në kuadër të Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”, pjesë e syllabuseve të lëndëve përfshihet edhe literatura e detyrueshme dhe ajo e këshillueshme. Studentët njihen me literaturën e programit mësimor në fillim të çdo viti akademik dhe gjatë zhvillimit të procesit të mësimdhënies përmes ndërveprimeve me pedagogët përgjegjës. Literatura është e disponueshme në format elektronik dhe në kopje të shtypura, duke u siguruar kështu që studentët të kenë akses të plotë në materialet e nevojshme. Pas një shqyrtimi të syllabuseve të lëndëve dhe moduleve të ndryshme, vihet re se literatura e përdorur është bashkëkohore dhe përputhet me kërkesat moderne akademike dhe kërkesa të fushave përkatëse. Biblioteka e UMSH disponon 4200 tituj librash për këtë program. <i>Evidenca 41 Material per biblioteken</i>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integrimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”, ka një strukturë të qartë për përditësimin e literaturës dhe sigurimin e burimeve të duhura për studentët. Njësia kryesore dhe njësia bazë e programit janë të inkurajuara nga UMSH për të kërkuar dhe përditësuar literaturën akademike me botime të viteve të fundit, për

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	të siguruar që materialet e përdorura në procesin mësimor të jenë sa më bashkëkohore dhe të pasqyrojnë zhvillimet e fundit në fushat përkatëse të studimit. Pedagogët ekspertë të lëndëve të tyre janë përgjegjës për monitorimin dhe identifikimin e botimeve të reja që janë të rëndësishme për lëndët dhe temat që ata mbulojnë. Kur një pedagogu i kërkohet të përditësojë literaturën, ai njofton njësinë kryesore të programit të studimit përmes një procesi të mirëorganizuar që përfshin kërkesat specifike për mbledhjen e materialeve të reja. Njësia kryesore më pas e transmeton këtë kërkesë në përputhje me procedurat administrative dhe financiare të institucioni, duke mundësuar mbështetje për blerjen e literaturës dhe përditësimin e materialeve për studentët. Ky proces siguron që literaturën e përdorur në programet e studimit të jetë e freskët, relevante dhe e përditësuar, duke pasur gjithashtu një ndikim pozitiv në cilësinë e mësimdhënies dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe kërkesat e fushës. <i>Evidenca 41 Material per biblioteken</i> <i>Evidenca 42 kerkese per libra</i>
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Aksesi në bibliotekë është i hapur dhe mundësohet për të gjithë studentët e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”. Biblioteka është e organizuar dhe e paisur me një hapësirë të përshtatshme për përdorimin e burimeve në kushte optimale, duke siguruar një mjedis të favorshëm për studim dhe kërkim akademik. Në kuadër të të drejtave të tyre, studentët kanë mundësinë për të përdorur pa diskriminim gjithë infrastrukturën dhe shërbimet që ofron universiteti për mbështetje të procesit mësimor. Ata mund të aksesojnë mjediset e bibliotekës, si dhe të shfrytëzojnë çdo shërbim tjetër të disponueshëm për realizimin e plotë të programit të studimit. Ky qasje e barabartë ndaj shërbimeve dhe resurseve mbështetëse siguron mundësi të pandërprera për zhvillimin e aktivitetit akademik dhe arritjen e objektivave të studimit. <i>Evidenca 41 Material per biblioteken</i> <i>Evidenca 24 Relacion i Verifikimit te godines</i>
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë,	Biblioteka e UMSH është e pajisur me fond fizik. Biblioteka është e organizuar me rafte të hapura ku e gjithë literatura është e ekspozuar.

literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga pikëpamja infrastrukturore biblioteka është e pajisur me tavolina leximi dhe PC. Biblioteka e UMSH disponon 4200 tituj librash për këtë program. Në përbërje të fondit fizik të bibliotekës gjenden zhanre të ndryshëm në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Po ashtu biblioteka mundëson aksesin në biblioteka online Cobiss, EIFL, Edward Elgar Publishing, biblioteka digjitale e UMSH me 17,000 libra elektronike. <i>Evidenca 41 Material per biblioteken</i> https://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Në kuadër të procesit mësimor të Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”, institucioni siguron akses të plotë në bibliotekë për të gjithë studentët e këtij programi. Shfrytëzimi i burimeve të bibliotekës, që përfshin literaturën në gjuhë shqipe dhe gjuhë të huaj, mundësohet në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë kosto për studentët. Personeli përgjegjës i bibliotekës është i angazhuar për të garantuar që të gjithë studentët të kenë mundësinë për të shfrytëzuar burimet dhe shërbimet e bibliotekës pa asnjë dallim, duke siguruar një qasje të barabartë dhe të aksesueshme ndaj literaturës dhe materialeve mbështetëse për zhvillimin e procesit akademik. <i>Evidenca 41 Material per biblioteken</i> https://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	Biblioteka është e pajisur me tavolina studimi, PC si dhe programe kompjuterike që lejon aksesin në biblioteka online Cobiss, EIFL, Edward Elgar Publishing, biblioteka digjitale e UMSH me 17,000 libra elektronike. <i>Evidenca 41 Material per biblioteken</i> https://biblioteka.umsh.edu.al:8020/EbooksServer/user-registration/index.php
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret	Biblioteka është në dispozicion të studentëve gjatë orarëve të shërbimit, të cilat përshtaten me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Oraret janë të afishuara në hyrje të saj.

e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Përgjegjësi i bibliotekës ka rolin e ndjekjes dhe raportimit për cilësinë e fondit fizik dhe atij online të bibliotekës. Fondi i bibliotekës, si ai fizik ashtu edhe ai online, përditësohen dhe pasurohen vazhdimisht me literaturë bashkëkohore. Blerja e librave të rinj realizohet kryesisht në bazë të kërkesave që vijnë nga departamentet, për t'iu përgjigjur nevojës për përditësimin dhe pasurimin e literaturës që mbështet programet e studimit. <i>Evidenca 41 Material per biblioteken</i> <i>Evidenca 42 kerkese per libra</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se personeli akademik ofron për studentët literaturën e detyrueshme dhe atë të këshillueshme, të cilat janë pjesë e syllabuseve të lëndëve dhe janë bashkëkohore dhe cilësore.</i> <i>Burimet e literaturës mund të aksesohen në bibliotekë, e cila disponon një infrastrukturë të përshtatshme dhe një fond fizik të literaturës, si dhe ofron akses në libraritë online. Studentët dhe personeli akademik kanë të drejtën e përdorimit të mjediseve dhe shërbimeve të bibliotekës, në përputhje me nevojat shkencore të realizimit të programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.asc.al

Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Institucioni menaxhon të dhënat e studentëve përmes një sistemi të sofistikuar dhe efikas të menaxhimit të informacionit. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për organizimin dhe ruajtjen e dokumenteve dhe të dhënave që lidhen me studentët dhe procesin mësimor. Ajo siguron që regjistrat e studentëve të administrohen në mënyrë të saktë dhe të përditësohen vazhdimisht. Të dhënat e studentëve regjistrohen si në regjistra fizike, ashtu edhe në Sistemin e Menaxhimit të Studentëve (SMS), ndërkohë që informacioni personal përditësohet gjithashtu në versionin elektronik. <i>Gjithashtu, pas një verifikimi të kryer nga GVJ në Sekretarinë Mësimore, u konstatua se administrimi i regjistrave realizohet në përputhje me rregulloret dhe legjislacionin përkatës në fuqi.</i> <i>Evidenca 30 Manual i përdorimit të SMS</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Institucioni ka krijuar dhe implementuar një sistem të brendshëm menaxhimi që mundëson administrimin e të gjithë dokumentacionit që lidhet me aktivitetet e realizuara për mbështetje të programit të studimit. Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për organizimin dhe arkivimin e çdo dokumenti të dhënë që lidhet me studentët dhe procesin mësimor. Ajo ruan dhe menaxhon dosjet personale të studentëve, përfshirë rezultatet e provimeve dhe çdo dokumentacion tjetër, si në formë shkresore ashtu edhe elektronike. Gjithashtu, Sekretaria Mësimore është përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e regjistrave dhe dokumentacionit të lidhur me procesin mësimor në të dyja formatet, shkresor dhe elektronik. Administrimi i të dhënave është dixhitalizuar plotësisht përmes përdorimit të Sistemit të Menaxhimit të Studentëve (SMS), që mundëson një mbështetje më të efektshme dhe të përditësuar të procesit administrativ. <i>Evidenca 30 Manual i përdorimit të SMS</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Sistemi SMS është i organizuar me pjesë dhe nivele akses si për personelin akademik dhe atë ndihmës. Studentët kanë llogaritë e tyre në SMS. <i>Evidenca 30 Manual i përdorimit të SMS</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të	UMSH ka implementuar Sistemin e Menaxhimit të Studentëve (SMS) që nga viti 2017, i cili mundëson studentëve akses në materiale dhe dokumentacione të natyrës akademike dhe financiare. Ky sistem ofron një platformë të centralizuar, duke siguruar

komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	informacion të përditësuar për çdo aspekt të jetës akademike dhe financiare të studentëve.			
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi SMS garanton monitorim në kohë reale dhe përmban informacionet që i referohen programit të studimit dhe sillabuseve të lëndëve. Gjithashtu, përmes këtij sistemi, njësitë administrative përkatëse menaxhojnë informacionin lidhur me burimet njerëzore, aspektet financiare dhe elementët e tjerë që kanë të bëjnë me programin e studimit. Ky sistem mundëson një administrim të centralizuar dhe të thjeshtuar të të dhënave, duke siguruar efikasitet dhe transparencë në proceset akademike dhe administrative.			
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstaton se institucioni përdor disa kanale komunikimi publik për të shpërndarë informacionin lidhur me programin e studimit, duke përfshirë website-in e tij zyrtar dhe rrjetet sociale. Website-i zyrtar i UMSH është https://www.umsh.edu.al/ . UMSH ka një praktikë të rregullt për publikimin e informacioneve relevante në faqen e internetit, e cila ofron informacion dhe pasqyrë të aktiviteteve të institucionit në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Faqja është e strukturuar mirë dhe ofron seksione kryesore si Pranimet, Rreth Nesh, Studimet, Studentët, Kërkimi Shkencor, Ndërkombëtarizimi, dhe Të reja. Ky strukturim e bën faqen të lehtë për t'u naviguar, duke mundësuar filtrimin e informacionit dhe marrjen e informacionit të kërkuar. https://www.umsh.edu.al/			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se UMSH administron dhe menaxhon të dhënat që i referohen programit të studimit nëpërmjet një sistemi efikas menaxhimi. Ky sistem mundëson administrimin dhe monitorimin në kohë reale të informacionit, duke siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor për këtë program studimi. Sistemi i menaxhimit përfshin platforma të integruara të dedikuara për shkëmbimin e informacionit mes personelit akademik dhe studentëve, që është një nga mënyrat më të mira për të rritur aksesin dhe efikasitetin e informacionit. Kjo lejon një komunikim të vazhdueshëm dhe të drejtpërdrejtë, duke kontribuar në përmirësimin e bashkëpunimit dhe menaxhimit të procesit mësimor.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Institucioni ka një qasje të strukturuar dhe transparente në menaxhimin financiar të programit të studimit. Ai siguron raporte të rregullta dhe plane të detajuara, të përqëndruara në sigurimin e burimeve të nevojshme për të garantuar një funksionim të qëndrueshëm dhe cilësor të programit. Ky menaxhim financiar është i orientuar drejt optimizimit të burimeve dhe përmbushjes së kërkesave akademike dhe infrastrukturore, duke mbështetur përparimin e vazhdueshëm të programit të studimit. Njësitë bazë përcjellin nevojat e tyre në njësinë kryesore të cilat i përcillen Administratorit, i cili harton projekt buxhetin dhe e përcjell për miratim Bordit të Administrimit. <i>Evidenca 16.2 Te dhena Financiare</i> <i>Evidenca 16.3 Pasqyrat Financiare Raporti i Auditit</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Institucioni pasqyron gjendjen financiare në përputhje me aktet e brendshme dhe kërkesat ligjore që rregullojnë veprimtarinë financiare. Pasqyrimi i gjendjes financiare për çdo program studimi është një detyrim i parashikuar nga rregulloret e brendshme të institucionit. Plani financiar tregon në detaje ndarjen e burimeve financiare, përfshirë shpenzimet dhe të ardhurat. Të ardhurat që mbështesin programin e studimit burojnë kryesisht nga tarifat e shkollimit, projektet dhe burime të tjera financiare. Ky plan përfshin alokimin e fondeve për burimet njerëzore që kontribuojnë në realizimin e programit, për shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjisë, dhe për investimet në bibliotekë dhe aksesin në burime online. Plani financiar paraqet një pamje të qartë të resurseve të nevojshme për të siguruar funksionimin efikas të programit të studimit dhe mbështetje të qëndrueshme për studentët, duke krijuar një mjedis mësimor të përshtatshëm dhe të avancuar. Me këtë qasje, institucioni siguron që të gjitha aspekte të menaxhimit financiar të jenë të integruara dhe të mbështesin në mënyrë optimale realizimin e objektivave të programit të studimit. <i>Evidenca 16.2 Te dhena Financiare</i> <i>Evidenca 16.3 Pasqyrat Financiare Raporti i Auditit</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe	GVJ konstaton se institucioni ka një praktikë të rregullt të kryerjes së auditimit periodik(çdo vit, nga auditues të pavarur dhe të

dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	certifikuar) vlerësimit dhe dokumentimit të gjendjes financiare, duke siguruar transparencë dhe efektivitet në menaxhimin e burimeve financiare. Ky proces auditimi dhe vlerësimi ndihmon në monitorimin e përdorimit të fondeve dhe në identifikimin e mundësive për përmirësimin e menaxhimit financiar të programit të studimit dhe të gjithë institucioni. <i>Evidenca 16.3 Pasqyrat Financiare _Raporti i Auditit</i>
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Institucioni ka një qasje të organizuar dhe transparente në administrimin financiar të programit të studimit. Ai siguron raporte të detajuara dhe plane financiare që janë të përqendruara në sigurimin e burimeve të nevojshme për të mbështetur funksionimin efikas dhe të qëndrueshëm të programit. Ky menaxhim është i orientuar për të maksimizuar përdorimin e burimeve financiare dhe për të plotësuar kërkesat akademike dhe infrastrukturore, duke siguruar përmirësimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e programit të studimit. <i>Evidenca 16.2 Te dhena Financiare</i> <i>Evidenca 16.3 Pasqyrat Financiare _Raporti i Auditit</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Institucioni ka krijuar struktura të specializuara për planifikimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve financiare, me qëllim sigurimin e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë financiare të programit të studimit.
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se UMSH realizon vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes së tij financiare në përputhje me politikat e brendshme dhe kërkesat ligjore. Ai gjithashtu siguron përmbushjen e detyrimeve të tij financiare përmes auditimit të brendshëm dhe auditimit të jashtëm, duke garantuar transparencë dhe efikasitet. Raportet financiare të hartuara përfshijnë shpërndarjen e burimeve financiare në nivel institucional, duke përfshirë gjithashtu planet e financimit që i referohen programit të studimit, me fokus në përdorimin e burimeve për mbështetje të veprimtarisë akademike dhe infrastrukturore.</i>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar kostaton që Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” harton dhe implementon një kuadër politikash dhe procedurash që mbulojnë të gjithë ciklin akademik të studentëve, nga regjistrimi deri në diplomim, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë dhe udhëzimet e MAS. Këto politika janë të dokumentuara në aktet e brendshme rregullatore, duke përfshirë Statutin dhe Rregulloren e studimeve universitare, dhe sigurojnë një proces të organizuar dhe të standardizuar për çdo fazë të kalimit të studentëve nëpër sistemin akademik. Studentët kanë mundësinë të njoftohen dhe të kenë qasje në informacionin përkatës përmes platformave të institucionit, duke siguruar një proces të qartë dhe të mirëmenaxhuar gjatë gjithë cikut të studimit. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 4 Plani Strategjik UMSH</i> <i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit Bsc SHPA me profile</i> <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i> <i>Evidenca 8 Rregullore DSHPMN</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe	Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” zbaton politika dhe procedura të qarta, të drejta dhe gjithëpërfshirëse për të siguruar mundësi të barabarta për të gjithë kandidatët për studentët e programit të studimit. Nga procesi i pranimit deri në përfundimin e studimeve, të gjitha rregulloret dhe

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

studentët e programit të studimit.	praktikat e institucionit janë të ndërtuara në përputhje me parimet e barazisë dhe drejtësisë në arsimin e lartë. GVJ konstaton se pranimi dhe ndjekja e studimeve në Programin e Ciklit të Parë, Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profilet “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”, bazohet në standarde të qarta dhe transparente. Të gjitha informacionet për kriteret dhe procedurat e pranimit bëhen publike, duke siguruar akses të barabartë për të gjithë aplikantët. Për më tepër, zbatimi i këtyre politikave nga strukturat akademike dhe administrative të institucionit garanton respektimin e të drejtave të studentëve në mënyrë të paanshme dhe të barabartë gjatë gjithë ciklit të studimeve. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 5 Strategjia e Zhvillimit Bsc SHPA me profile</i> <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimit. Kjo bën procesin e pranimit të transparent dhe i jep mundësi të gjithë kandidatëve të kenë një kuptim të qartë rreth kriterëve që do të aplikohen dhe mënyrës së vlerësimit. <i>Në rastin e programit në fjalë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” GVJ konstaton se IAL nuk ka përcaktuar kriteret shtese përveç atyre të parashikuara në legjislacion.</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i> https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimit
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	GVJ konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” garanton që të gjitha kriteret dhe procedurat që lidhen me pranimin, përzgjedhjen e studentëve, përparimin akademik, transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme apo të pjesshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin të jenë të qarta, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme nga publiku. Dokumentet rregullative të institucionit përcaktojnë në mënyrë të detajuar dhe të strukturuar këto procese, duke siguruar një gjuhë të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë, pa paqartësi apo interpretime të

	dyzuara. Çdo informacion që lidhet me programin e studimit publikohet në mënyrë transparente, duke garantuar akses të plotë për të gjithë të interesuarit. <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i> https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimi https://www.umsh.edu.al/c/151/dokumentacioni https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	GVJ bazuar evidencave në dispozicion konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” publikon në faqen zyrtare, kriteret për pranimin e kandidatëve në çdo program. Po ashtu IAL organizon javë informimi dhe prezantimi për të interesuarit në programin e saj të studimit. https://www.umsh.edu.al/c/150/kriteret-e-pranimi https://www.umsh.edu.al/c/151/dokumentacioni
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ bazuar dokumentacionit të dorëzuar, specifikisht evidenca 18 “Rregullore për studentët me aftësi ndryshe”, kreu II, neni 6 dhe 7 përcakton në mënyrë eksplicite se për pranimin e studentëve me aftësi ndryshe zbatohen të njëjta dispozita pranimi sipas legjislacionit në fuqi. <i>Evidenca 18 Rregullore per studentet me aftesi ndryshe</i>
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	N/A
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ konstaton se Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Mesdhetar i Shqipërisë” në zbatim të Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 3, datë 02.07.2024, u akordon bursa kategorive të ndryshme të aplikantëve që duan të kryejnë studimet në ciklin e studimeve Bachelor. IAL ofron skema të ndryshme bursash për studentët e regjistruar për herë të parë, bazuar në kriteret sociale, akademike dhe të talentit. Kategoria 1 mbulon deri në 3% të studentëve me financim të plotë për ata në nevojë sociale ose me ekselencë akademike (mesatare 9.7-10). Kategoria 2 ofron tarifa të reduktuara (80,000 Lekë) për studentë me mesatare 9.0-9.7, mbi 45 vjeç, me kushte ekonomike të vështira ose të talentuar në fusha të ndryshme. Kategoria 3 (160,000 Lekë) dhe Kategoria 4 (180,000 Lekë) synojnë

	mbështetjen e studentëve me rezultate të mira (mesatare 8.5-9.0) dhe atyre me të ardhura të ulëta. <i>Bursat ofrohen për një vit akademik dhe mund të rinovohen nëse përmbushen kriteret e mesatares dhe kërkesat e përcaktuara në Aneks Kontratën e bursave. Të gjitha aplikimet kryhen online përmes faqes zyrtare të UMSH.</i> https://www.umsh.edu.al/c/110/bursat			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se UMSH harton dhe publikon politika dhe procedura të qarta, të aksesueshme dhe transparente për pranimin, përzgjedhjen dhe përparimin e studentëve, si dhe për transferimin, njohjen e studimeve të mëparshme, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin. Këto rregullore janë të disponueshme publikisht, duke siguruar informim të plotë dhe akses të barabartë për të gjithë të interesuarit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Ofrimi i informacionit të plotë dhe të detajuar mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit nga një vit në tjetrin është një element thelbësor i transparencës dhe komunikimit me studentët. Kjo praktikë u mundëson atyre të kenë një kuptim të qartë mbi mënyrën se si monitorohet dhe vlerësohet performanca e tyre. Në dokumentet rregullative, UMSH ka përcaktuar qartë notat minimale të kalueshmërisë, kërkesat për pjesëmarrje, procedurat e vlerësimit dhe rishikimit të notave, si dhe kriteret për avancimin akademik, duke përfshirë kalendarët akademikë dhe udhëzimet përkatëse. Përveç përcaktimit të tyre në aktet rregullative të IAL, informacioni mbi strukturën akademike, lëndët, syllauset, kalendarin akademik etj u prezantohet studentëve në javën e parë të vitit akademik. Strukturat e tjera si sekretaria mësimore, sporteli i informacionit, sistemi SMS, website zyrtar, janë po ashtu një burim informacioni për studentët. <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i>



	<i>Evidenca 20 Udhezues per studentet</i> https://www.umsh.edu.al/ https://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Në përputhje me parimet e Kartës së Bolonjës, në aktet e brendshme rregullatore, përcaktohet se UMSH pranon transferime të studentëve nga universitete të tjera, nëpërmjet sistemit të krediteve ECTS. Rregullorja për Organizimin dhe Punën e Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, neni 44 dhe 45, parashikon kushtet dhe procedurat e transferimit të studimeve, nga bërja e kërkesës me shkrim nga studenti, deri në njohjen e lëndëve dhe regjistrimin e tij në këtë program studimi. Informacioni është i qartë dhe lehtësisht i aksesueshëm po ashtu edhe në faqen zyrtare të institucionit. <i>Rekomandohet që Komisioni i Transferimit të Fakultetit të Drejtësisë dhe Shkencave Humane, i angazhuar me procesin e njohjes dhe konvertimit të lëndëve të jetë i kujdesshëm në këtë proces (referuar vendimi 1207/390, datë 23.09.2023).</i> <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 20 Udhezues per studentet</i> https://www.umsh.edu.al/c/153/transferimet
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ konstaton se Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë ofron informacion të qartë dhe të aksesueshëm për të ndihmuar studentët të orientohen më mirë gjatë studimeve të tyre. Në rregulloren “Për organizimin dhe punën në Fakultetin e Drejtësisë dhe Shkencave Humane” (kreu VIII) si edhe në rregulloren e programit (kreu V) të studimit janë përcaktuar qartë procedurat e kontrollit të dijes, sistemi i vlerësimit, përfshirë provimet, riprovimet, ankimimi dhe përmirësimet. Ky informacion u mundëson studentëve të kenë një pasqyrë të qartë mbi mënyrën se si do të vlerësohet performanca e tyre dhe çfarë pritet prej tyre gjatë studimeve, duke i ndihmuar të planifikojnë më mirë angazhimin e tyre akademik. <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i> <i>Evidenca 20 Udhezues per studentet</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Procedurat që lidhen me punimin e diplomës dhe procesin e diplomimit janë të përcaktuara në aktet e brendshme të Universitetit Mesdhetar të Shqipërisë. Rregullorja e fakultetit (kreu X) dhe rregullorja për këtë program studimi (kreu VI) përshkruajnë qartë kriteret dhe kushtet për hartimin e punimit të diplomës. Gjithashtu, këto rregullore rregullojnë edhe aspektet e diplomimit. Informacioni i detajuar mbi këto procedura është i përfshirë edhe në dokumentet informuese të dedikuara për studentët.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i> <i>Evidenca 17 Pyetje orientuese</i> <i>Evidenca 20 Udhezues per studentet</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” siguron që të gjithë të interesuarit për programin e studimit të marrin informacion të plotë dhe të qartë përpara fillimit të çdo viti akademik. Kjo realizohet përmes aktiviteteve të ndryshme si takime informuese, panaireve dhe shpërndarja e materialeve promovuese si broshura informuese. Po ashtu, rrjetet sociale dhe faqja zyrtare e institucionit shërbejnë si hapësira të rëndësishme komunikimi, duke ofruar akses të vazhdueshëm në informacion për studentët e ardhshëm. <i>Evidenca 31 Broshura e programeve Bachelor</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” ofron informacion të qartë, të plotë dhe lehtësisht të aksesueshëm mbi kriteret e përparimit akademik, njohjen dhe vlerësimin e dijeve deri në diplomim. Ky informacion, i përcaktuar në aktet rregullative dhe dokumentet informuese për studentët, mbulon të gjitha aspektet e procesit akademik në programin Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profilet “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike”.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Kohëzgjatja dhe struktura e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në rregulloren mësimore. Ky informacion u komunikohet studentëve përmes kanaleve të ndryshme si faqja zyrtare e institucionit, rrjetet sociale, materialet promocionale dhe informuese, si dhe përmes aktiviteteve të posaçme si takime, panaire dhe biseda të drejtpërdrejta me stafin akademik. <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
 Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i> <i>Evidenca 31 Broshura e programeve Bachelor</i> <i>Evidenca 20 Udhezues per studentet</i> https://www.umsh.edu.al/c/102/fakulteti-i-drejtësisë-dhe-shkencave-humane
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Ky kriter respektohet në mënyrë të rregullt, duke siguruar një strukturë të qartë dhe të aksesueshme për studentët. Dokumentet kryesore, si kurrikula dhe rregullorja e programit të studimit, përmbajnë informacion të detajuar mbi lëndët/modulet, përmbajtjen e tyre dhe veprimtaritë formuese. Gjithashtu, syllabuset e lëndëve përcaktojnë objektivat akademike, përmbajtjen dhe format e vlerësimit të dijeve, duke u bërë të disponueshme për studentët përmes platformave zyrtare të institucionit. <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i> <i>Evidenca 31 Broshura e programeve Bachelor</i> <i>Evidenca 13 Plani mesimor Bsc SHPA me profile</i> <i>Evidenca 13.2 Syllabuset e lendeve</i> https://www.umsh.edu.al/c/102/fakulteti-i-drejtësisë-dhe-shkencave-humane
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ konstaton se bazuar vizitës në IAL, takimit me studentët si edhe takimi me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, studentët marrin informacion të vazhdueshëm dhe të strukturuar mbi mundësitë e punësimit dhe zhvillimet në tregun e punës. Ky proces mbështetet nga njësia bazë dhe Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, e cila luan një rol kyç në orientimin profesional të studentëve. Gjatë studimeve, ata përfitojnë mbështetje të dedikuar për zhvillimin e karrierës, duke përfshirë mundësi punësimi, praktika profesionale dhe opsione për studime të mëtejshme. Përmes këshillimit individual dhe aktiviteteve informuese, studentët ndihmohen të identifikojnë mundësitë më të përshtatshme për ta dhe të përgatitin aplikimet e tyre në mënyrë efektive, duke rritur kështu shanset e tyre për sukses në tregun e punës. https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres <i>Evidenca 48 Rregullore ZKSK</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e	Orari dhe plani mësimor u bëhen të ditura studentëve përmes kanaleve zyrtare të komunikimit të institucionit. Gjithashtu, ata informohen në lidhje me logjistikën dhe infrastrukturën akademike, duke përfshirë ambientet e përdorura gjatë studimeve si sallat e

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	leksioneve dhe seminareve, bibliotekën, laboratorët dhe hapësirat e tjera të dedikuara për procesin mësimor. <i>Evidenca 26 kalendari i aktivitetit akademik</i> <i>Evidenca 31 Broshura e programeve Bachelor</i>		
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” përdor një sistem të dedikuar për menaxhimin e informacionit akademik, i cili mundëson regjistrimin dhe ruajtjen e të dhënave të studentëve. Ky sistem siguron informacion të detajuar mbi modulet, kreditet dhe procesin akademik. Secili student ka llogarinë e vet në websitin zyrtar. http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar		
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se institucioni ka ndërmarrë hapa të qartë dhe të strukturuar për të siguruar informimin e studentëve në çdo aspekt të jetës akademike dhe profesionale. Studentët kanë mundësi të informohen në mënyrë të plotë mbi objektivat formues, organizimin dhe përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe perspektivat e punësimit, duke shfrytëzuar kanale të ndryshme komunikimi dhe burime informuese të institucionit.</i>		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Institucioni kryen monitorim të rregullt të performancës së programit të studimit duke mbledhur dhe analizuar statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar. Këto të dhëna ofrojnë një pasqyrë të qartë mbi ecurinë e programit dhe shërbejnë si bazë për përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij. Sekretaria mban statistika mbi numrin e të diplomuarve për programin e studimit, gjë e cila u konfirmua edhe nga vizita në institucion dhe takimi me personelin e sekretarisë mësimore.

Mbështetur në Evidencën 'Permbledhje e tabelave' rezulton se numri i studentëve të regjistruar në katër vite akademike për këtë program është:

Viti akademik	Programi/profili	Te regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali
21-22	Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profil "Politikat e Integritit dhe Qeverisje"	6	3	9
	Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profil "Administratë Publike"	17	14	31
22-23	Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Shkenca Politike dhe Administrative", me profil "Politikat e Integritit dhe Qeverisje"	8	11	19
	Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Shkenca	23	13	36

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

		Politike dhe Administrative”, me profil “Administratë Publike”			
	23-24	Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profil “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje”	4	4	8
		Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profil “Administratë Publike”	14	24	38
<i>Evidenca ‘Permbledhje e tabelave’</i> <i>Evidenca 45 Rregullore e Sekretarise mesimore</i>					
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Institucioni mban të dhëna mbi studentët në një databazë elektronike. Këto të dhëna përfshijnë informacion mbi numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimit, ecurinë akademike të tyre, mesataren e notës dhe indikatorë të tjerë të rëndësishëm. Po ashtu, ruhet informacion mbi tërheqjet nga programi. Kjo mundëson monitorimin e vazhdueshëm të performancës së studentëve dhe ndihmon në vlerësimin dhe përmirësimin e programit të studimit. <i>Evidenca ‘Permbledhje e tabelave’</i> <i>Evidenca 45 Rregullore e Sekretarise mesimore</i>				
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet	Të dhënat statistikore që u referohen studentëve administrohen jo vetëm në format fizik, por edhe elektronik. Ky informacion				

të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	administrohet nga strukturat kompetente në përputhje me rolet dhe përgjegjësitë e tyre. Informacioni është lehtësisht i verifikueshëm nga personat e autorizuar. http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar			
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe Sekretarinë mësimore pa nga afër proceset e administrimit të regjistrave dhe mori disa raste për kontroll të saktësisë së mirëmbajtjes. Sekretaria mësimore dhe institucioni raporton këto të dhënë edhe në raportin vjetor që Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë i dërgon Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ku përfshihet numri i përditësuar i studentëve të diplomuar. Regjistrat plotësohen në formë të shkruar dhe format elektronik duke ruajtur të dhënat në zbatim të udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi. <i>Evidenca Dokumentacioni shtesë i përcjellë me shkresën me Nr. 1553 datë 7.11.2024.</i>			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Njësia bazë harton raporte mbi cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. Përmes analizave të tilla, institucioni mund të bëjë ndryshime të nevojshme për të siguruar një përvojë më të mirë dhe një përgatitje më të mirë të studentëve për tregun e punës.			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se ky kriter përmbushet plotësisht, pasi institucioni mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5 Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstaton gjatë shqyrtimit të dokumentacionit por dhe vizitës në institucion, se studentët janë të përfshirë dhe angazhuar në organizmat vendimmarrëse të UMSH në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutores. Studentët organizohen në Këshillin Studentor. Po ashtu Neni 11 i Statutit përcakton se në Senatin Akademik në masën 10 % përfaqësohen nga studentët. Po ashtu 1 student është pjesë e Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave. <i>Rekomandohet që studentët të përfaqësohen edhe në Këshillin e Etikës.</i> <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 47 Rregullore e funksionimit të Keshillit studentor</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	UMSH siguron një përfshirje të vërtetë dhe konkrete të studentëve dhe përfaqësuesve të tyre në proceset vendimmarrëse, këshillimore dhe vlerësuese lidhur me procesin akademik. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 47 Rregullore e funksionimit të Keshillit studentor</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	GVJ, gjatë takimeve me studentët, diskutoi mbi përfshirjen e tyre në proceset e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit. Studentët përfaqësohen në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave. Po ashtu studentët gëzojnë të drejtën e studentëve për të shprehur vlerësimin e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies dhe performancën e stafit akademik, përmes pyetësorëve të realizuar në mënyrë të rregullt. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 47 Rregullore e funksionimit të Keshillit studentor</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lendes nga studentit</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të	Rregulloret e brendshme të institucionit dhe të programit të studimit sanksionojnë të drejtën e studentëve të shprehin qëndrimin e tyre mbi procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Studentet kanë të drejtën të shprehen në lidhje me procedurën si

vlërësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	dhe shkallën e vlerësimit të dijeve të tyre nëpërmjet procesit të ankimimit dhe kërkesës për rivlerësim. <i>Evidenca 6 Rregullore e FDSHH</i> <i>Evidenca 7 Rregullore e Programit Bsc SHPA</i> <i>Evidenca 8 Rregullore DSHPMN</i> <i>Evidenca 21 Udhezim mbi procedurat dhe afatet e sezonit te provimeve</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se institucioni përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	UMSH ka njësi të posaçme si Sekretaria mësimore, Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve. Po ashtu infrastruktura teknologjike përmes portalit të studentëve bën të mundur informimin në kohë reale të studentëve. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 2 Rregullore e Organizimit UMSH</i> <i>Evidenca 48 Rregullore ZKSK</i> http://sms.umsh.edu.al:8001/Sistemi_Menaxhimit_Uni_Mesdhetar https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	UMSH ka struktura mbështetëse, si akademike ashtu edhe të tjera, për të ofruar informacion, këshillim dhe asistencë për studentët në lidhje me programin e studimit. Disa nga këto struktura përfshijnë: Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës, Sekretaria e Pranimeve, Sekretaria Mësimore etj të gjithë janë në dispozicion të plotë të studentëve për tu shërbyer dhe mbështetur. <i>Evidenca 3 Organigrama</i>

Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës në UMSH ofron mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë periudhës së studimeve, duke siguruar këshillim dhe orientim profesional. Kjo zyrë ofron shërbime që ndihmojnë studentët në zhvillimin e aftësive të nevojshme për tregun e punës, si dhe asistencë në identifikimin e objektivave të karrierës. Gjithashtu, ajo ofron mbështetje në përgatitjen e aplikimeve, praktika dhe mundësi punësimi, duke siguruar një kalim të suksesshëm nga studimet në botën profesionale. <i>Evidenca 48 Rregullore ZKSK</i> https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	Zyra e Këshillimit të Studentëve dhe Karrierës dhe zyra Alumni në UMSH ndjekin me kujdes studentët edhe pas diplomimit, duke mbajtur kontakte të vazhdueshme me ta për të monitoruar integrimin e tyre në tregun e punës. Këto struktura mbledhin dhe përpunojnë të dhëna dhe statistika mbi suksesin e Alumni në fushën profesionale, duke vlerësuar ndikimin e programit të studimit në karrierën e tyre dhe mundësitë e zhvillimit profesional që ata kanë arritur pas përfundimit të studimeve.			
Konkluzione	<i>GVJ konkludon se institucioni ka krijuar dhe zbatuar procedura të qarta dhe struktura të dedikuara për pritjen, orientimin dhe këshillimin e studentëve. Për më tepër, institucioni ka gjithashtu procedura të qarta për menaxhimin e ankimimeve dhe problematikave që mund të lindin gjatë periudhës së studimeve, duke siguruar një mbështetje të plotë dhe efikase për çdo çështje që mund të hasin studentët. Ky angazhim i institucioneve siguron që studentët të kenë një eksperiencë akademike të mbështetur, transparente dhe të drejtë, dhe i mundëson atyre të adresojnë çdo problem apo shqetësim në mënyrë të shpejtë dhe profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë organizon trajnime dhe seminare për zhvillimin profesional të stafit akademik, duke ofruar mundësi për përmirësimin e aftësive të tyre në fusha të ndryshme. Këto trajnime përfshijnë aspekte didaktike të mësimdhënies, si dhe metoda bashkëkohore dhe inovative për një qasje më efektive në auditor. Përmes këtyre aktiviteteve, institucioni synon të mbështesë pedagogët në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe krijimin e një përvoje më të pasur akademike për studentët. <i>Evidenca 25 Programi i trajnimeve</i> <i>Evidenca 32 Levizje e stafit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	Strukturat përgjegjëse në institucion zbatojnë mekanizma të rregullt monitorimi dhe vlerësimi për të siguruar cilësinë e mësimdhënies dhe për të inkurajuar praktikat inovative nga personeli akademik dhe ndihmësakademik. Këto procese realizohen përmes vlerësimeve periodike të personelit akademik nga ana e studentëve përmes pyetësorëve semestral, analizave të performancës të personelit nga autoriteti drejtues, feedback-ut nga studentët përmes focus grupeve dhe aktiviteteve trajnuese, duke synuar përmirësimin e vazhdueshëm të metodave të mësimdhënies dhe rritjen e efikasitetit në procesin akademik. Institucioni në mënyrë të përvitshme harton raportet e veprimtarisë institucionale të cilat përmbledhin analizën mësimore dhe kërkimit shkencor me të gjithë komponentët e vlerësimit të tij. <i>Evidenca 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lëndës nga studenti</i> <i>Evidenca 27 Formular i Vlerësimit të pedagogut nga autoriteti drejtues</i> <i>Evidenca 28 Plani i Monitorimit DSHPMN</i> <i>Evidenca 29 Procedura e punës me focus grupet</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punës NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise

Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	Një nga mekanizmat kryesorë të vlerësimit të procesit mësimor është zhvillimi i sondazhit të studentëve në përfundim të çdo semestri. Këto sondazhe u mundësojnë studentëve të japin mendimin e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies dhe përmbajtjen e lëndëve të ndjekura. Të dhënat e mbledhura shqyrtohen nga NJSBCZHK, e cila kryen analizat përkatëse dhe ndan gjetjet me departamentin dhe stafin akademik. Po ashtu sikurse përmendur më sipër realizohen edhe focus grupe me studentët. Gjithashtu, studentëve u ofrohet mundësia për të rishikuar dhe përmirësuar vlerësimet e tyre akademike përmes procedurave të ankimimit dhe rishqyrtimit të notave, duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent vlerësimi. <i>Evidenca 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca 28 Plani i Monitorimit DSHPMN</i> <i>Evidenca 29 Procedura e punës me focus grupet</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punës NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Pranë UMSH funksionon NJSBCZHK, struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie. Të dhënat e sondazheve të realizuara me studentët përpunohen dhe analizohen, duke u reflektuar në raportet vjetore të njësisë. Këto raporte shqyrtohen dhe diskutohen në mbledhjet e departamentit, duke u bërë gjithashtu të aksesueshme për publikun nëpërmjet faqes zyrtare të UMSH. <i>Evidenca 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca 28 Plani i Monitorimit DSHPMN</i> <i>Evidenca 29 Procedura e punës me focus grupet</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punës NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	UMSH bazuar në mekanizmat e vlerësimit dhe analizën e rezultateve të marra, identifikon dhe promovon praktikat më të mira në mësimdhënie. Në këtë kuadër, ai inkurajon personelin akademik për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe përmirësim të metodave të tyre pedagogjike, duke krijuar një mjedis që nxit inovacionin dhe cilësinë në procesin mësimor. <i>Evidenca 25 Programi i trajnimeve</i> <i>Evidenca 32 Levizje e stafit</i>




Konkluzione	GVJ konstaton se UMSH ka të përcaktuara dhe zbaton politika dhe procedura të qarta për garantimin e cilësisë së mësimdhënies. Struktura përgjegjëse, NJSBCZHK, kryen monitorimin e rregullt të performancës së personelit akademik përmes një sërë mekanizmash, duke përfshirë sondazhet studentore, grupet e fokusit, vlerësimet periodike dhe analizën e rezultateve akademike. Të dhënat e mbledhura përpunohen dhe analizohen me qëllim identifikimin e aspekteve për përmirësim, promovimin e praktikave të mira dhe rritjen e cilësisë së procesit mësimor. Për transparencë dhe përfshirje të gjerë, raportet dhe gjetjet përkatëse bëhen publike dhe diskutohen në strukturat akademike përkatëse.			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	UMSH e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me Statutin, aktet rregullatore dhe Ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe përmirësimi i vazhdueshëm i të gjithë komponentëve të tij përbën një nga objektivat kryesorë të zhvillimit të institucionit. Universiteti përcakton dhe zbaton politika të qarta për sigurimin e cilësisë, të cilat janë të pasqyruara në dokumente përkatëse ku parashikohen parimet dhe standardet për rritjen e cilësisë akademike dhe administrative. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) funksionon si një strukturë e specializuar në nivel universiteti. Përbërja dhe veprimtaria e saj janë të miratuara nga Rektori dhe të përcaktuara në një rregullore të veçantë. Kjo njësi përfshin një drejtues, anëtarë të përzgjedhur nga stafi akademik i departamenteve, përfaqësues të administratës, si dhe një anëtar të Këshillit të Studentëve, duke siguruar një përfaqësim të gjerë dhe gjithëpërfshirës në proceset e sigurimit të cilësisë. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punës NJSBCZHK</i>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) është njësi e specializuar që operon në nivel universiteti, e krijuar për të siguruar dhe përmirësuar vazhdimisht cilësinë e aktiviteteve akademike dhe zhvillimin e kurrikulave. Struktura dhe funksionimi i kësaj njësie janë miratuar nga Rektori i universitetit dhe rregullohen nga një rregullore e posaçme që përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të saj. NJSBCZHK zbaton një strategji të qartë dhe të qëndrueshme institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, e cila përfshin pjesëmarrjen aktive të studentëve. Kjo qasje siguron një monitorim dhe vlerësim të plotë të aktiviteteve akademike. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punes NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	Sigurimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë është pjesë e strategjisë institucionale si dhe planeve të veprimit në nivel institucional. Në kuadrin e vlerësimit të cilësisë, UMSH ka zbatuar procedurat e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit në përputhje me rregullimet ligjore. Universiteti ka respektuar detyrimet ligjore që lidhen me aplikimin për akreditimin programi pranë ASCAL. Ky program ka ardhur nga riorganizimi i programit Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile: a. Shkenca Politike; b. Administratë Publike”, licensuar me UMASH Nr. 482, datë 03.10.2011 dhe akredituar me Urdhër Nr. 124, datë 29.03.2012 dhe VBA Nr. 61 datë 28.09.2018. Akreditim i Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritimit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë” kryhet për herë të parë. Aplikimi zyrtar është dorëzuar në ASCAL më datë 24.11.2023 (Shkresë e IAL Nr. 1725 Prot, datë 20.11.2023, regjistruar në protokollin e ASCAL Nr. 246 Prot., datë 24.11.2023. http://ams.ascal.al/ams/components/expertpanel/procedurat_timeligne.php?id=24174

Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.	GVJ konstaton se përdoren tregues të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim për pasqyrimin dhe përmirësimin e cilësisë. Institucioni ka përcaktuar tregues që identifikojnë cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor si dhe përcaktojnë arritjet më të mira dhe mangësitë më qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Programet mësimore i nështrohen vlerësimit të brendshëm të cilësisë, rezultatet e të cilave bëhen publike. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 23 Formulari i vlerësimit të pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca 28 Plani i Monitorimit DSHPMN</i> <i>Evidenca 29 Procedura e punës me fokus grupet</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punës NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise			
Konkluzione	<i>Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shpreh mendimin se UMSH harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3 Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive,	Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit përbën një objektiv kryesor në strategjinë institucionale të UMSH. Në funksion të kësaj, institucioni zbaton një qasje të strukturuar për vlerësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të programeve akademike. Përmes metodave të ndryshme të analizës dhe procesit të rishikimit periodik, sigurohet që programet e studimit të jenë në përputhje me standardet më të larta akademike dhe të adresojnë nevojat e tregut të punës. Vlerësimi i cilësisë kryhet në mënyrë të vazhdueshme për të garantuar përmirësimin dhe efektivitetin e programeve të ofruara.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në kuadrin e mbikqyrjes së programit të studimit institucioni ka përdorur një sërë metodash, përfshirë edhe feedbackun që merret nga studentët. Këto sondazhe i referohen vlerësimeve të studentëve në lidhje lëndën, performancën e stafit, dhe metodologjinë e mësimdhënies. https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise <i>Evidenca 23 Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i>
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Stukurat e UMSH hartojnë raportin e analizës vjetore të mësimit dhe punës kërkimore shkencore ku përfshihet performanca e stafit dhe veprimtarisë në çdo komponent të saj, qoftë atë mësimor apo kërkimor si dhe formimi profesional i studentëve. Raporti i përcillet Rektoratit, Drejtuesit të njësisë kryesore dhe njësisë bazë. Në rast të problematikave diskutohet për zgjidhjen e tyre. NJSBCZHK harton planin e punës për përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. Po ashtu ka dhe një kalendar për monitorimin e njësisë bazë. <i>Evidenca 23 Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca 28 Plani i Monitorimit DSHPMN</i> <i>Evidenca 29 Procedura e punes me focus grupet</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punes NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara,	UMSH zbaton një qasje të strukturuar dhe të vazhdueshme për vlerësimin e cilësisë, duke u mbështetur në standardet për arsimin e lartë. Procesi i vlerësimit përfshin analiza të detajuara mbi aspekte të ndryshme të veprimtarisë akademike dhe institucionale, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të programeve dhe shërbimeve të ofruara. Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies bëhet nëpërmjet analizave periodike, të asistuarit në orën e mësimit (leksione apo seminare), nëpërmjet sondazhit të studentëve dhe fokus grupeve. UMSH i kushton një rëndësi të veçantë mbështetjes së studentëve, duke u angazhuar në monitorimin e vazhdueshëm të progresit të tyre akademik, integrimin në tregun e punës dhe forcimin e bashkëpunimeve me institucione dhe subjekte të ndryshme. Monitorimi i hyrjeve dhe daljeve të studentëve realizohet përmes sistemesh të posaçme, duke vlerësuar frekuentimin e tyre në procesin

rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	mësimor dhe identifikimin e nevojave për mbështetje shtesë. Për të diplomuarit, institucioni zhvillon strategji efektive që lehtësojnë punësimin, përfshirë këshillimin e karrierës, organizimin e panairove të punës dhe krijimin e rrjeteve të bashkëpunimit me tregun e punës. Marrëveshjet me institucione publike dhe private, si dhe me organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, synojnë të ofrojnë mundësi praktike profesionale dhe eksperiencia akademike që ndihmojnë studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe të përgatiten për sfidat e tregut të punës. Përmes këtyre iniciativave, UMSH siguron një mbështetje të gjithanshme për studentët e tij, duke i ndihmuar të ndërtojnë një bazë të fortë për suksesin e tyre akademik dhe profesional. <i>Evidenca 14 Analiza e tregut te punes</i> <i>Evidenca 10 Lista e Marreveshjeve te Bashkepunimit</i> <i>Evidenca 23 Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca 28 Plani i Monitorimit DSHPMN</i> <i>Evidenca 29 Procedura e punes me focus grupet</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punes NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 48 Rregullore ZKSK</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise https://www.umsh.edu.al/c/36/keshillimi-i-karrieres
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Për të siguruar realizimin, mbarëvajtjen dhe cilësinë e programeve të studimit, institucioni zbaton një qasje gjithëpërfshirëse të vlerësimit, duke përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme të analizës indirekte. Përmes mekanizmave të strukturuar (sondazhe, fokusgrupe, vlerësimi nga palë të treta), vlerësohen aspektet kyçe të programit, duke përfshirë përmbajtjen akademike, efektivitetin e mësimdhënies dhe përputhshmërinë me kërkesat e tregut të punës. Ky proces synon identifikimin e pikave të forta dhe atyre që kërkojnë përmirësim, duke mundësuar ndërhyrje të vazhdueshme për rritjen e cilësisë dhe përshtatjen e programeve sipas nevojave të studentëve dhe zhvillimeve akademike e profesionale. <i>Evidenca 14 Analiza e tregut te punes</i> <i>Evidenca 23 Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca 28 Plani i Monitorimit DSHPMN</i> <i>Evidenca 29 Procedura e punes me focus grupet</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punes NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i>

Konkluzione	GVJ konstaton se institucioni kryen një monitorim të rregullt të cilësisë dhe analizon gjetjet e tij për të përmirësuar proceset akademike. Të dhënat e mbledhura shërbejnë si bazë për adresimin e sfidave të identifikuara dhe për përhapjen e praktikave të suksesshme, duke kontribuar në zhvillimin e vazhdueshëm të cilësisë në institucion.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Sigurimi i cilësisë në UMSH përfshin një gamë të gjerë aktorësh, duke përfshirë personelin akademik, stafin ndihmës administrativ, studentët, strukturat drejtuese, palët e treta dhe institucionet rregullatore si ASCAL. Institucioni ka ndërtuar një sistem efikas për sigurimin e cilësisë, duke krijuar struktura të dedikuara që mundësojnë një vlerësim të brendshëm të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës. Në këtë proces, të gjithë aktorët e përfshirë kanë mundësinë të kontribuojnë në mënyrë aktive përmes pjesëmarrjes në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Personeli akademik dhe administrativ luajnë një rol kyç në zbatimin dhe zhvillimin e politikave të cilësisë, ndërsa studentët marrin pjesë në vendimmarrje përmes përfaqësimit në Senat dhe përfshirjes në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK). Përveç përfshirjes direkte, institucionit i mundësohet marrja e opinioneve të studentëve dhe stafit përmes mekanizmave të ndryshëm të vlerësimit të cilësisë, si sondazhet dhe analizat periodike. Nga ana tjetër, aktorët e jashtëm luajnë një rol të rëndësishëm në sigurimin e cilësisë përmes përfaqësimit në strukturat institucionale të vlerësimit dhe bashkëpunimit me institucione publike dhe private, si brenda vendit ashtu edhe në nivel ndërkombëtar. Këto partneritete ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe në sigurimin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat e tregut të punës dhe standardet akademike.

	<i>Evidenca 23 Formulari i vleresimit te pedagogut dhe lendes nga studenti</i> <i>Evidenca 28 Plani i Monitorimit DSHPMN</i> <i>Evidenca 29 Procedura e punes me focus grupet</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punes NJSBCZHK</i>
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Institucioni ka ndërtuar një kuadër të qartë politikash për sigurimin e cilësisë, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. Rregulloret dhe aktet e brendshme institucionale specifikojnë rolet e stafit akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ, duke garantuar që secili kontribuon në mënyrë aktive në sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë. Strukturat e sigurimit të cilësisë mbikëqyrin dhe koordinojnë bashkëpunimin mes aktorëve të ndryshëm, duke siguruar zbatimin efektiv të politikave institucionale dhe angazhimin e të gjithë palëve të interesuara. Për më tepër, këto struktura krijojnë mekanizma për përfshirjen e studentëve në procesin e sigurimit të cilësisë, duke u dhënë atyre mundësinë të marrin pjesë në vendimmarrje përmes përfaqësimit në organe si Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zhvillimit të Kurrikulave (NJSBCZHK) dhe Senati Akademik. Kjo qasje gjithëpërfshirëse siguron një proces vlerësimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm, duke reflektuar nevojat dhe pritshmëritë e të gjitha palëve të interesuara. <i>Evidenca 1 Statuti UMSH</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i>
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.	Në procesin e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programeve të studimit janë të përfshira një sërë strukturash dhe aktorësh, duke përfshirë njësitë bazë (departamentet) dhe strukturën kryesore përgjegjëse për programin e studimit. Ky proces është i mbështetur nga personeli akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, si dhe nga studentët që ndjekin programin e studimit. Angazhimi i një sërë aktorësh dhe palësh të interesuara në vlerësimin e cilësisë kontribuon në përmirësimin dhe zhvillimin e vazhdueshëm të saj, duke siguruar një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në të gjitha nivelet e programit të studimit. <i>Evidenca 28 Plani i Monitorimit DSHPMN</i> <i>Evidenca 33 Plani i Punes NJSBCZHK</i> <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i>
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të	Përfshirja e të gjithë aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të cilësisë realizohet duke u mbështetur në parimet e integritetit akademik, barazisë dhe parandalimit të diskriminimit. Në përputhje me këto parime, aktet rregullatore të brendshme përcaktojnë

respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	procedura të qarta për përfshirjen e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, të cilat sigurojnë që proceset të zhvillohen në një mënyrë të barabartë dhe transparente. Kjo siguron një ambient të drejtë dhe pa diskriminim, ku të gjithë aktorët kanë mundësinë të kontribuojnë në vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike.			
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Në UMSH, bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm janë pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë. Ata kontribuojnë me njohuritë dhe ekspertizën e tyre për të vlerësuar dhe përmirësuar cilësinë e programeve të studimit. Ky angazhim i jashtëm është i rëndësishëm për mbajtjen e standardeve të larta dhe për siguruar përputhshmërinë e programeve me nevojat e tregut të punës dhe kërkesat e fushës përkatëse.			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se nëpërmjet politikave të sigurimit të cilësisë, UMSH siguron angazhimin e një gamë të gjerë aktorësh në procesin e vlerësimit të cilësisë dhe mundëson marrjen e kontributeve të vlefshme nga secili aktor përkatës. Aktet e brendshme të institucioni përcaktojnë qartë detyrat dhe përgjegjësitë për të gjithë aktorët e angazhuar në këtë proces, duke siguruar një strukturë të qartë të angazhimit dhe funksionimit.</i> <i>Përfshirja e aktorëve të brendshëm në procesin e vlerësimit të cilësisë bëhet në përputhje me parimet e integritetit akademik, barazisë dhe parandalimin e çdo forme diskriminimi. Pjesë e rëndësishme e këtij procesi janë edhe bashkëpunëtorët dhe ekspertët e jashtëm, të cilët, përmes njohurive dhe eksperiencës së tyre profesionale, kontribuojnë në analizën dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. Kjo mundëson një qasje më të gjerë dhe më të balancuar në vlerësimin dhe zhvillimin e programit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat, strategjitë, organizimi dhe aktivitetet që lidhen me sistemin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë të hapura dhe transparente. Të gjitha këto informacione bëhen publike në faqen e webit për studentët dhe për çdo person tjetër të interesuar, duke siguruar qasje të plotë dhe të drejtpërdrejtë në proceset që lidhen me vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë akademike. Ky nivel transparence i mundëson palëve të interesuara të monitorojnë dhe kontribuojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit. https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Institucioni ka zhvilluar një politikë dhe procedura të qarta, të përcaktuara në aktet e tij të brendshme rregullatore, për publikimin e materialeve që lidhen me veprimtarinë institucionale. Ky publikim realizohet në përputhje me rregullat dhe standardet e etikës akademike, duke siguruar transparencë dhe respektimin e parimeve të besueshmërisë dhe integritetit në komunikimin e informacionit. <i>Evidenca 50 Rregullore NJSBCZHK</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Në kuadër të vlerësimit të brendshëm, hartohen raporte vjetore që pasqyrojnë rezultatet e aktiviteteve akademike të institucionit, duke identifikuar arritjet dhe fushat që kërkojnë përmirësim. Këto raporte përfshijnë gjithashtu rekomandime për adresimin e mangësive dhe zhvillimin e praktikave të reja. Rekomandimet drejtohen tek strukturat përgjegjëse për sigurimin e cilësisë, të cilat, si pjesë e strategjive të përmirësimit të vazhdueshëm, krijojnë plane të detajuara veprimi. Këto plane përfshijnë masat konkrete që do të ndërmerren për të arritur objektivat e përcaktuara dhe për të përmirësuar cilësinë e procesit akademik.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Në përputhje me aktet e tij rregullatore, institucioni vlerëson ndikimin dhe efektivitetin e aktiviteteve të ndërmarra në kuadër të procesit të sigurimit të cilësisë për programin e studimit. Ky vlerësim realizohet përmes një sërë procedurash dhe mekanizmash, si raporte vjetore, anketa, plane veprimi dhe analiza të tjera. Qëllimi është përfshirja e sa më shumë strukturave dhe niveleve, duke nisur nga niveli institucional deri te njësitë përkatëse akademike dhe administrative, për të siguruar një vlerësim të plotë dhe gjithëpërfshirës të procesit të cilësisë.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për	Institucioni ka krijuar një sërë metodash e mjetesh për informimin e të gjithë të interesuarve mbi proceset e sigurimit të cilësisë, si trajnime, takime, etj. Informimi realizohet edhe nëpërmjet publikimit të raporteve të vlerësimit të cilësisë dhe informacioneve në faqen zyrtare të institucionit. Rritja e ndërgjegjësimin të

sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	studentëve mbi rëndësinë e përfshirjes në sigurimin e cilësisë të programit të studimit mundësohet edhe nëpërmjet angazhimit të studentëve në Këshillin Studentor apo Klubet Studentore ku studentët marrin pjesë aktive. <i>Evidenca 25 Programi i trajnimeve</i> https://www.umsh.edu.al/c/125/sigurimi-i-cilesise			
Konkluzione	<i>GVJ shpreh qendrimin se te gjithë proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë publike dhe transparente. Ato bëhen publike për studentët, stafin akademik dhe gjithë të interesuarit bazuar në parimin e transparencës nëpërmjet publikimit në faqen web të institucionit apo komunikimeve zyrtare.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike dhe Administrative”, me profile “Politikat e Integritetit dhe Qeverisje” dhe “Administratë Publike” ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë”.


Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi është i organizuar dhe i strukturuar në përputhje me objektivat formues dhe kërkesat ligjore.
2. Ekziston një sistem funksional i sigurimit të brendshëm të cilësisë, me përfshirje të aktorëve të ndryshëm dhe mekanizma të strukturuar vlerësimi.
3. Programi përfshin staf akademik të kualifikuar, me qëndrueshmëri dhe mbulim të ngarkesës mësimore sipas kërkesave ligjore.
4. Infrastrukturë dhe mjete moderne mësimore.

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Pika të dobta:

1. Stafi akademik nuk është ende plotësisht i njohur me procedurat rregullative institucionale, siç janë ato që lidhen me administrimin e programeve lëndore, administrimin e kontrollit të dijeve, ankimimin etj.
2. Studentët nuk janë të përfaqësuar në Këshillin e Etikës, ndonëse janë të përfshirë në struktura të tjera.

Rekomandime:

1. Programi i studimit duhet rishikuar nga pikëpamja kurrikulare në profilin "Administratë Publike" në mënyrë që të realizohet përputhja e nevojës për dije, kompetenca dhe aftësi të profilit dhe disiplinave përkatëse.
2. Familjarizimi dhe trajnimi i personelit akademik mbi procedurat e administrimit, përditësimin dhe dokumentimin të programeve të lëndëve.
3. Rekomandohet që studentët të përfaqësohen edhe në Këshillin e Etikës, për të rritur përfshirjen e tyre në vendimarrje.
4. Sugjerohet forcimi i kuadrit rregullator për procesin e njohjes dhe konvertimit të lëndëve.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Political and Administrative Sciences", with the profiles "Integration Policies and Governance" and "Public Administration", provided by the Higher Education Institution "Mediterranean University of Albania".

Strengths and affirmations

1. The program is organized and structured in accordance with the formative objectives and legal requirements.
2. A functional internal quality assurance system is in place, involving various stakeholders and structured evaluation mechanisms.
3. The program includes a qualified academic staff, ensuring continuity and coverage of the teaching load in line with legal requirements.
4. Modern teaching infrastructure and resources are available

Weaknesses

1. The academic staff is not yet fully familiar with the institutional regulatory procedures, such as those related to course program administration, knowledge assessment management, appeals processes, etc.
2. Students are not represented in the Ethics Council, although they are involved in other institutional structures.



Recommendation

1. The study program should be revised from a curricular perspective in the "Public Administration" profile, in order to ensure alignment with the knowledge, competencies, and skills required by the profile and its respective disciplines.
2. Familiarization and training of academic staff on procedures related to the administration, updating, and documentation of course syllabi.
3. It is recommended that students be represented in the Ethics Council, in order to enhance their participation in decision-making processes.
4. It is suggested to strengthen the regulatory framework for the process of course recognition and credit transfer.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X



V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al